# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5557
E enjte, 23 gusht 2018
çmimi 0.40 €


## Ministri Bytyqi thotë se shkollat verore kanë rëndësi të veçantë në arsim

FAQE 6




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de




FLET PËR "EPOKËN E RE", XHAVIT HALITI FAQE 4-5

# Çështjen e veteranëve të UÇK-së nuk mund ta zgjidhë drejtësia

**- Ky trend i politikës në Kosovë, që të gjithë të bëhen veteranë të arsimit, veteranë të luftës, veteranë të kësaj apo të saj çështje dhe që të gjithë të paguhen, do ta falimentojë shtetin**

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, nuk beson se drejtësia mund ta zgjidhë problemin e listave të veteranëve të UÇK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai nuk ka treguar ndonjë ide konkrete se si mund të rregullohet kjo çështje, por ka theksuar se zgjidhja duhet të shihet jashtë organeve të drejtësisë. Haliti, i cili është një ndër themeluesit e UÇK-së, ka bërë me dije se komandantët e zonave dhe ata të brigadave kanë të dhëna për numrin e ish-luftëtarëve të lirisë. "Nuk mund të them nëse kanë qenë 60 mijë veteranë, 10 mijë, 12 mijë apo 20 mijë siç po flitet. Shifrat janë të ndryshme, por mendoj se askush nuk po ia qëllon", ka thënë Haliti, duke shtuar se kjo çështje duhet të rregullohet me gjakftohtësi. "Nuk mund të fshihen të gjithë ata që vërtet kanë kontribuar për lirinë e vendit", ka porositur Haliti

## Opozita kërkon dorëheqjen e kryeministrit Haradinaj

FAQE 3

Pas zhvillimeve të fundit në sistemin e drejtësisë, partitë opozitare kanë kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinaj. Sipas zyrtarëve opozitarë, Haradinaj nuk mund të jetë edhe më tutje kryeministër për shkak të ndërhyrjes së tij në sistemin e drejtësisë. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se është detyrë qytetare dhe obligim politik të kërkohet dorëheqja e Haradinajt. Edhe deputetja e LDK-së, Vjosa Osmani, ka kërkuar që urgjentisht të hidhet në votim mocioni për rrëzimin e Qeverisë Haradinaj



## Hapet konkursi për drejtorë të bordeve për 14 ndërmarrje publike

Në katërmbëdhjetë ndërmarrje publike është hapur konkursi për drejtorë të bordeve. Konkursi është i hapur 30 ditë, nga data 22 gusht deri më 22 shtator FAQE 9

### AKTUALE

**TRYEZA PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI E THIRRUR NGA BAHTIRI NXJERR PESË KONKLUZIONE** F. 7

**SHOQATA E PROKURORËVE: BLAKAJ S'KA SHPREHUR ASNJË KËRCËNIM** F. 6

**KOLEGJI ISPE ANKOHET NË ENQA DHE EQAR PËR ARSIMIN E LARTË** F. 6

### EKONOMI

**ALBENA RESHITAJ DO TA UDHËHEQË TASK FORCËN PËR PASTRIMIN E KOSOVËS** F. 8

**VALUTA RUSE SHËNON ULJE** F. 9

### EKONOMI

**NJË LIBËR TEJET I VEÇANTË PËR TË DREJTAT PRONËSORE NË KOSOVË** F. 12
Prof. dr. Abdullah KARJAGDIU

### SPORT

**BERISHA: E MPOSHTIM EDHE LLAPIN** F. 16

**MKRS-ja: PRISHTINA - DRENICA ZHVILLOHET NË STADIUMIN 'FADIL VOKRRI'** F. 18


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax.: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# BE-ja pret referendum të suksesshëm në Maqedoni




**Shkup, 23 gusht** - "Sa më shumë afrohet data e mbajtjes së referendumit, qendrat vendosëse dëshirojnë të përçojnë mesazh të qartë se Maqedonia, si shtet, e ka mbështetjen e tyre të fuqishme në procesin e integrimeve euroatlantike. Megjithatë, partitë në pushtet, të cilat janë shprehur pro referendumit, nevojitet që përmes kontakteve të drejtpërdrejta t'u shpjegojnë qytetarëve se cilat perspektiva hapen për vendin me votën e tyre pozitive për marrëveshjen Maqedoni - Greqi në referendumin e shtatorit", kështu i shohin njohësit e çështjeve politike porositë që vijnë nga Uashingtoni dhe Brukseli lidhur me rëndësinë e rezultatit pozitiv në referendum.
Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shkup, Samuel Zbogar, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se dëshiron që referendumi të jetë i suksesshëm, sepse në këtë mënyrë dëshiron të shohë se si Maqedonia ecën para dhe arrin t'i fillojë bisedimet për anëtarësimin e vendit në BE gjatë vitit të ardhshëm. "Dëshiroj të shoh se referendumi është i suksesshëm. Dhe, më duhet të theksoj se në këtë nuk jam i vetëm. Sigurisht keni vërejtur se muajt e fundit, si asnjëherë më parë, keni marrë porosi pozitive, si dhe janë realizuar shumë vizita nga liderë të Evropës në Maqedoni. Ata e ndjekin nga afër situatën, dhe kjo demonstron dëshirën e liderëve të Evropës që ta shohin vendin se si ecë para, të shohin se si përmirësohet situata dhe ta shohin fillimin e bisedimeve për anëtarësimin e vendit në BE gjatë vitit të ardhshëm. Mendoj se të gjithë e ndiejmë se tani është koha, nuk ka alternativë tjetër të mirë ose më të mirë nga ajo që është ofruar tani", ka deklaruar Zbogar.
Ndërkohë, në lidhje me referendumin është deklaruar edhe komisionari për Zgjerim dhe Fqinjësi të mirë i BE-së, Johanes Hahn. Ai ka theksuar se referendumi në Maqedoni paraqet zgjedhje mes së ardhmes në Bashkimin Evropian dhe izolimit. "Referendumi paraqet zgjedhje drejt së ardhmes së BE-së, integrimit me përfitime konkrete për qytetarët, si sundimi i ligjit, tërheqja e investimeve të huaja, hapja e shumë vendeve të reja të punës dhe rrugës drejt izolimit, ngecjes dhe lëshimit të shansit të vetëm për përmirësimin dhe përparimin në sferat kyçe", ka theksuar Hahn.
Ai referendumin e ka krahasuar mes koncepteve nacionaliste dhe integrimit të vendit në NATO dhe BE. "Zgjedhja është mes lëvizjes nga konceptet e vjetra nacionaliste ose të ardhmes së vendit me reforma dhe integrimit në BE dhe NATO, si destinacion përfundimtar. Kjo nuk është e imponuar nga BE-ja apo bashkësia ndërkombëtare. Integrimi euroatlantik është vendosur si qëllim strategjik i vendit qysh më herët. U takon qytetarëve të vendosin nëse kjo perspektivë me të gjitha përfitimet do të materializohet", është shprehur Hahn.

### Mbështetja ndërkombëtare, inkurajim për qytetarët që të dalin në referendum

Selim Ibrahimi nga Qendra për Studime të Sigurisë dhe Zhvillim në Maqedoni, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se porositë e qarta që vijnë nga zyrtarët e të lartë të ShBA-së dhe BE-së, se referendumi duhet të jetë i suksesshëm që menjëherë pas kësaj të shfrytëzohet shansi që vendi të ecë me hapa grandiozë në procesin e integrimeve euroatlantike, në masë të madhe kanë si synim inkurajimin e qytetarëve maqedonas të rreshtohen pro referendumit, veçanërisht ata të cilët janë të papërcaktuar ose që ende hamenden rreth daljes në referendum. "Kjo përkrahje që vjen nga bashkësia ndërkombëtare ka mundësi ta ndryshojë mendimin, përkatësisht opinionin e qytetarëve maqedonas, të cilët ende kanë hamendje sepse shqiptarët, më se 98 për qind janë shprehur pozitivisht për referendumin si mundësi që i hap rrugë procesit të integrimeve. Në fakt, bashkësia ndërkombëtare nuk mund të bëjë më shumë nga kjo që po bën, sepse në duart e qytetarëve të Maqedonisë mbetet se si do të vendosin të votojnë në referendumin e shtatorit. Vendi ndodhet në një pikë shumë të rëndësishme dhe këtë qytetarët e Maqedonisë duhet ta kuptojnë", ka vlerësuar Ibrahimi.
Ndërsa Nikolla Dujovski, njohës i çështjeve politike, ka theksuar se nevojitet një fushatë më agresive nga ana e Qeverisë dhe shumicës parlamentare për t'ua sjellë për së afërmi qëndrimet e qendrave vendimmarrëse. "Këto mesazhe të drejtpërdrejta që vijnë nga Uashingtoni dhe Brukseli do të kenë efekt vetëm nëse Parlamenti, si bartës për realizimin e fushatës për referendumin, përkatësisht shumica parlamentare e cila favorizon të votojë pro referendumit, arrin t'ua servojë qytetarëve si politikë që ata ta kenë të qartë se nëpër cilën rrugë ka vendosur të ecë Maqedonia", ka thënë Dujovski për "Radion Evropa e Lirë".
Të mërkurën sekretari i Departamentit Amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, gjatë takimit me shefin e diplomacisë maqedonase, Nikolla Dimitrov, ka pohuar se "ShBA-ja pret që Maqedonia të bëhet anëtarja e 30 e NATO-s, pas realizimit të suksesshëm të referendumit në shtator".
Edhe kancelarja gjermane Angela Merkel ka theksuar se "mbështet rrugën e Maqedonisë drejt NATO-s dhe BE-së" gjatë një bisede telefonike që ka realizuar po të mërkurën me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev, ka njoftuar Qeveria e Maqedonisë.
Ndërsa faktori ndërkombëtar shpreh keqardhje se nuk është arritur një konsensus gjithëpërfshirës rreth referendumit ndërmjet pushtetit dhe opozitës, VMRO DPMNE-ja ende nuk është prononcuar nëse do t'i ftojë qytetarët të votojnë kundër apo ta bojkotojnë në tërësi referendumin.

## Bushati: Çështja Kosovë - Serbi të përmbyllet me njohje reciproke

**Tiranë, 23 gusht** - Një marrëveshje për njohje të ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë do të sillte normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve, por edhe garanci të fortë për stabilitetin e rajonit. Kështu ka thënë ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, në një takim me përfaqësues të Luginës së Preshevës.
Rreth debatit të korrigjimit të kufijve, ministri Bushati ka ndarë me bashkëbiseduesit qasjen e Shqipërisë në raport me këto zhvillime, duke e vënë theksin tek rëndësia e vijimësisë së dialogut dhe orientimin e tij në mënyrë efektive, në terma të qartë, pa ekuivokë dhe të balancuar sa i përket zbatimit të plotë të marrëveshjeve dhe avancimit të proceseve integruese të Kosovës. "Ne i qëndrojmë bindjes sonë se procesi i dialogut duhet të përmbyllet me një marrëveshje për njohje të ndërsjellë mes dy vendeve, që do të sillte jo vetëm normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes tyre, por edhe do të ishte një garanci e fortë për stabilitetin demokratik të të gjithë rajonit", ka thënë Bushati.
Temë bisede ishin edhe shqetësimet e parashtruara nga përfaqësuesit politikë të Luginës, për ecurinë socio-ekonomike, kulturore e arsimore, si dhe për mungesën e shërbimeve dhe të standardeve parësore që po çojnë drejt humbjes së perspektivës për të rinjtë dhe largimin e tyre nga Lugina.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Opozita kërkon dorëheqjen e kryeministrit Haradinaj



**Pas zhvillimeve të fundit në sistemin e drejtësisë, partitë opozitare kanë kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinaj. Sipas zyrtarëve opozitarë, Haradinaj nuk mund të jetë edhe më tutje kryeministër për shkak të ndërhyrjes së tij në sistemin e drejtësisë. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se është detyrë qytetare dhe obligim politik të kërkohet dorëheqja e Haradinajt. Edhe deputetja e LDK-së, Vjosa Osmani, ka kërkuar që urgjentisht të hidhet në votim mocioni për rrëzimin e Qeverisë Haradinaj**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 GUSHT - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, ka thënë se Qeveria e Kosovës është duke e penguar sundimin e ligjit. Ai ka theksuar se prokurori Elez Blakaj ka dhënë dorëheqje pas kërcënimeve të kryeministrit Haradinaj. "Shteti i kapur është në krizë ligjore. Amullia e Qeverisë së Kosovës është vetë kjo Qeveri. Ajo pengon sundimin e ligjit dhe çliron serinë e skandaleve. Së fundmi, kemi dorëheqjen e prokurorit Blakaj, të kërcënuar nga kryeministri. Kryeprokurori i Shtetit u diskreditua. Me atë që e tha (për vartësin e vet) pas asaj që nuk e bëri (për qytetarët e vendit). Ai është dashur të shkarkohet menjëherë (me propozimin e KPK dhe vendimin e presidentit ashtu siç e parasheh Kushtetuta e Kosovës në Nenin 84, pika 17)", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinaj dhe shkarkimin e kryeprokurorit të Shtetit, Aleksandër Lumezi.

Kurti ka vlerësuar se një kryeministër i këtillë, sikurse edhe një kryeprokuror i atillë, i bëjnë dëm shtetit tonë. "Kryeministri i vendit është personi i cili duhet ta administrojë dhe udhëheqë procesin e adresimit të së kaluarës, të krimeve të luftës e krimeve kundër njerëzimit, të krimeve të agresionit e të gjenocidit. Ai do të duhej të kishte ndjeshmëri të thellë dhe përgjegjësi të lartë e t'u japë rëndësi të gjitha viktimave të luftës - qofshin ato civile apo jo. Mirëpo ky kryeministër bëri të kundërtën duke ofenduar dhe poshtëruar viktimat civile të deportimit. Kjo është e papranueshme. Dhe, kryeministri na e sulmoi argumentin kryesor të popullit dhe shtetit tonë karshi Serbisë. Është detyrë qytetare dhe obligim politik të kërkohet dorëheqja e Ramush Haradinajt. Është e drejtë institucionale dhe nevojë shtetërore të shkarkohet ai. Një kryeministër i këtillë, sikurse edhe një kryeprokuror i atillë, nuk i bëjnë nder vendit tonë dhe i bëjnë dëm shtetit tonë", është shprehur Kurti, duke shtuar se për zgjidhjen e problemit në sistemin e drejtësisë nuk mjafton vetëm largimi i Haradinajt dhe Lumezit. Sipas tij, sistemi duhet pastruar nga matrapazët dhe duhet pasuruar me energji të re. "Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme për t'i zgjidhur problemet në sistem. Ai duhet pastruar nga matrapazët dhe duhet pasuruar me energji të re. Prandaj, duhet ndryshuar legjislacionin aktual të prokurorisë i cili pamundëson qasjen e personave të cilët nuk kanë kaluar disa vjet nëpër të njëjtin sistem të kalbur", ka theksuar Kurti.

Në këtë kontekst, ai ka thënë se ka ardhur koha që vendi të pastrohet nga prokurorët e dobët, nga prokurorët e lig, nga gjyqtarët e korruptuar dhe nga avokatët e pazotë. "Nuk duhet të merremi vetëm me politikanë të korruptuar. Është koha ta pastrojmë vendin si nga prokurorët e dobët, po ashtu edhe nga prokurorët e lig, nga gjyqtarët e korruptuar dhe nga avokatët e pazotë. E pastaj, jo vetëm qeveria e re, por asnjë qeveri e ardhshme s'do të jetë kurrë më si këto të vjetrat", ka deklaruar Kurti.

Edhe deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Vjosa Osmani, ka thënë se urgjentisht duhet të hidhet në votim mocioni për rrëzimin e Qeverisë Haradinaj. Ajo ka thënë se kryeministri Haradinaj ka bërë ndërhyrje të drejtpërdrejtë në sistemin e drejtësisë në rastin e prokurorit Elez Blakaj. Në rast të dështimit të mocionit të mosbesimit, Osmani ka paralajmëruar mobilizim qytetar për largimin e Haradinajt. "Ndërhyrje më të drejtpërdrejtë e më të shpërfaqur në sistemin e drejtësisë sesa kur kryeministri i kërkon prokurorit që raporti i hetimeve t'i dorëzohet atij nuk ka. Kjo nuk ndodh në demokraci. Kjo është tipike për sistemet autokratike e mafioze. Këtij sistemi duhet t'i jepet fund menjëherë. Mocioni për rrëzimin e Qeverisë duhet të hidhet në votim urgjentisht. Edhe nëse dështon, le të dihet sigurt kush është për e kush kundër kësaj qeverisjeje kleptokratike e të rrezikshme. E pastaj mobilizimi qytetar është ai që pason", ka shkruar Osmani në llogarinë e vet në "Facebook".



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
*Kryeministri - Premijer - The Prime Minister*

Date: August 23rd 2018

**Dear Ambassador,**

On 25th of September 2017, I received a request by, now former Special Prosecutor, Elez Blakaj, requesting support, cooperation and access in Archives of the Office for the Issues of the Categories from KLA War, located within Prime Minister's premises. In compliance with the objective of the Government to have Rule of Law as a top priority, I have provided my unconditional support to this request and within 24 hours I responded with a decision granting full access of Former Prosecutor Elez Blakaj and relevant Investigators to the premises and files. I have clearly underlined my full support to all investigation within the Office for the Issues of the Categories from KLA War in regard to the issue of the Veterans List. The letter consists of:

- Granting full and free access and without any pressure to Police Officers on duty: Rifat Gashi (No. 1232) and Ali Berisha (No. 6853) within the Archives of the Office for the Issues of the Categories from KLA War, where all the applications are kept and examine it for any investigation purposes, as they would require;
- Ensuring that no individual or Prime Minister's Office officials be present or involved in the process of investigations;
- In full agreement with former Prosecutor, the investigation in Office for the Issues of the Categories from KLA War will last for 30 days, and the Prosecutor will deliver a report of findings within the Office to the Prime Minister;
- Based on Prosecutors request, and the necessity for investigation process, Video surveillance system may be installed and to be monitored solely by investigators, and also change of key lock of the Archive Office where the documents are archived.

Ndërtesa e Qeverisë, Rr. Nënë Tereza, Kati II-të. Prishtinë, Republika e Kosovës
Telefoni: 00383 38 200 14145. Web: www.kryeministri-ks.net

## Haradinaj u shkruan letër ambasadorëve për rastin Blakaj

PRISHTINË, 23 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të enjten u është drejtuar me një letër ambasadorëve të akredituar në vendin tonë në lidhje me rastin e ish-prokurorit Elez Blakaj, i cili ka qenë duke hetuar listat e veteranëve të UÇK-së. Në letrën drejtuar ambasadorëve, Haradinaj ka shkruar se ia ka ofruar përkrahjen e plotë ish-prokurorit Blakaj për t'i hetuar këto lista. "Ish-prokurori Blakaj ka ardhur në zyrën time dhe ka kërkuar dy javë kohë për t'i zhvilluar hetimet në arkiv. Me vullnet të plotë për ta ndihmuar procesin kam qenë në dispozicion për çfarëdo kohe që ai e përcakton. Jemi dakorduar që pas 30 ditëve të ofrojë një raport për rrjedhën e hetimeve, specifikisht a ka pasur mundësi të hetojë pa ndërhyrje, paanshmërisht dhe me integritet të plotë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka thënë se qeveria dhe institucionet qendrore janë të vendosura ta forcojnë rendin dhe ligjin në Kosovë. "Politikat që kemi hartuar dhe zbatuar në rend e ligj, ndër të tjera, përfshijnë fuqizimin e rolit të prokurorëve dhe të gjyqtarëve, duke ua ngritur buxhetin sektorial, duke ngritur pagat dhe përmirësuar kushtet e punës. Këto politika ua kanë rikthyer dinjitetin dhe kanë fuqizuar tërë sistemin duke ngritur efektivitetin, transparencën dhe llogaridhënien", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se rastin në të cilin kishte punuar Blakaj meriton hetim të pavarur.

Kryeministri ka thënë se individët si Blakaj, duke manifestuar protagonizëm të rrejshëm me sulme ndaj drejtësisë, tentojnë t'i rrezikojnë përpjekjet për forcimin e sundimit të rendit dhe ligjit. "Ky rast nuk do ta pengojë vendosmërinë tonë të fortë për një sistem të plotë funksional të drejtësisë në Kosovë", ka theksuar Haradinaj.

Flet për "Epokën e re", Xhavit Haliti

# Çështjen e veteranëve të UÇK-së



## - Ky trend i politikës në Kosovë, që të gjithë të bëhen veteranë të arsimit, veteranë të luftës, veteranë të kësaj apo të saj çështje dhe që të gjithë të paguhen, do ta falimentojë shtetin

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, nuk beson se drejtësia mund ta zgjidhë problemin e listave të veteranëve të UÇK-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai nuk ka treguar ndonjë ide konkrete se si mund të rregullohet kjo çështje, por ka theksuar se zgjidhja duhet të shihet jashtë organeve të drejtësisë. Haliti, i cili është një ndër themeluesit e UÇK-së, ka bërë me dije se komandantët e zonave dhe ata të brigadave kanë të dhëna për numrin e ish-luftëtarëve të lirisë. "Nuk mund të them nëse kanë qenë 60 mijë veteranë, 10 mijë, 12 mijë apo 20 mijë siç po flitet. Shifrat janë të ndryshme, por mendoj se askush nuk po ia qëllon", ka thënë Haliti, duke shtuar se kjo çështje duhet të rregullohet me gjakftohtësi. "Nuk mund të fshihen të gjithë ata që vërtet kanë kontribuar për lirinë e vendit", ka porositur Haliti

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 23 GUSHT - Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, ka bërë me dije se çështjen e numrit të veteranëve të UÇK-së nuk mund ta zgjidhin organet e drejtësisë. Ai ka thënë se për zgjidhjen e këtij problemi duhet të shikohet që të gjendet një rrugë jashtë organeve të drejtësisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Haliti, i cili është një ndër themeluesit e UÇK-së, ka treguar se komandantët e zonave dhe ata të brigadave kanë të dhëna për numrin e luftëtarëve të lirisë. "Unë kam prirje t'i besoj drejtësisë, por mendoj se drejtësia apo prokuroria në Kosovë nuk mund ta zgjidhë këtë problem. Prokuroria duhet të përballet me secilin individ që mund të akuzohet për abuzim. Nëse dyshohen 19 mijë persona atëherë duhet të merren në pyetje 19 mijë veta", ka thënë Haliti. Ai nuk ka treguar për ndonjë ide konkrete se si mund të zgjidhet ky problem derisa ka kritikuar Ligjin për veteranët e UÇK-së. "Nuk kam ndonjë ide konkrete për këtë çështje. Por, do të thosha se e mira e së mirës është që të gjendet një rrugë. Nuk kam ndonjë formulë konkrete se si mund të zgjidhet, sepse sikur të kisha ndonjë formulë do ta thosha. Unë atëherë kam dalë kundër mënyrës së përcaktimit të rregullave në ligj për të qenë veteran dikush. Mendoj se gabimet janë bërë në hapat e parë kur është miratuar ligji për kategoritë e luftës, pastaj të tjerat vijnë njëra pas tjetrës", është shprehur ai.

Haliti ka kritikuar edhe propagandën e cila po bëhet ndaj veteranëve të UÇK-së. Ai ka sqaruar se nëse ka pasur abuzime me lista, përgjegjësia është individuale dhe askush nuk bën t'i fyejë veteranët. "Mua më brengos fakti se është ngritur një propagandë, një tymnajë ndaj veteranëve, të cilën nuk e meritojnë ata. Përgjegjësia

# ë nuk mund ta zgjidhë drejtësia



nëse ka pasur abuzime me këtë çështje, duhet të jetë individuale. Pra, përgjegjësia nuk mund të jetë grupore", është shprehur Haliti. Ai nuk ka dashur të flasë se sa ka qenë numri real i veteranëve të UÇK-së. "Nuk kam pasur asnjëherë evidencë të numrit të luftëtarëve, sepse unë nuk e kam pasur këtë detyrë. Prandaj nuk mund të them nëse kanë qenë 60 mijë, 10 mijë, 12 mijë apo 20 mijë siç po flitet. Shifrat janë të ndryshme, por mendoj se askush nuk po ia qëllon", ka thënë nënkryetari i Kuvendit të Kosovës.

**"Epoka e re":** *Z. Haliti, në Kosovë është hapur debati për numrin e veteranëve të UÇK-së. Cili është qëndrimi juaj për këtë çështje?*

**Haliti:** Tani është hapur një debat postfestum, sepse debati për miratimin e Ligjit për veteranët e UÇK-së ka qenë i hapur në parlament dhe atëherë ka qenë koha të parashihet gjithçka në ligj. Pra, që të parashihen masat konkrete vepruese kundër të gjithë atyre që abuzojnë me këtë çështje. Së pari, mua më brengos fakti se është ngritur një propagandë, një tymnajë ndaj veteranëve, të cilën nuk e meritojnë. Përgjegjësia nëse ka pasur abuzime me këtë çështje duhet të jetë individuale dhe nuk mund të jetë grupore. Së dyti, sa i përket përgjegjësisë politike, do të thosha se nëse ka pasur marrëveshje për t'ua plotësuar egon strukturave të ndryshme politike në bazë të funksionimit që kanë pasur partitë politike ose koalicionet në faza të caktuara, atëherë përgjegjësia politike është e atyre që kanë bërë marrëveshje. Së treti, ekziston një mendim apo debat jomedial, por njeriu në jetën e përditshme mund të hasë shumë lehtë në individë të cilët tregojnë se njerëzit kanë paguar nga 3 mijë, 4 mijë, 5 mijë, 8 mijë apo 10 mijë euro për të marrë statusin e veteranit të UÇK-së. Kjo për mua është tepër shqetësuese, sepse për ta marrë dikush statusin e veteranit pa qenë në luftë apo pa qenë i lidhur me UÇK-në nuk është në rregull. Nuk do të thotë se veteran duhet të jetë vetëm një njëri që e ka mbajtur pushkën në dorë. Askush nuk mund ta mbaj pushkën në luftë nëse nuk ka logjistikë, nëse nuk ka mbështetje politike, nëse nuk ka diplomaci që e mbështet dhe nëse nuk ka financim. Pra, të gjitha këto janë të lidhura njëra me tjetrën dhe asnjëra pa tjetrën nuk mund të funksionojnë. Mendoj se për luftëtarët e lirisë, komandantët e zonave, komandantët e brigadave kanë të dhënat e tyre të mjaftueshme që tregojnë se kush ka qenë e kush nuk ka qenë në luftë. Kjo çështje mund të sqarohet. Për mua problemi kryesor është ligji dhe mënyra se si është miratuar ligji, i cili nuk e penalizon askënd. Në ligj nuk shkruan se nëse dikush abuzon mund të dënohet. Prandaj ne duhet që hap pas hapi të gjykojmë me gjakftohtësi dhe ta rregullojmë këtë çështje, sepse nuk mund të fshihen të gjithë ata që vërtet kanë kontribuar për lirinë e vendit.

**"Epoka e re":** *Ndonëse nuk ka shifër të saktë se sa individë kanë përfituar statusin e veteranit të UÇK-së, mirëpo në opinion përmenden shifra se këtë status e kanë fituar rreth 60 mijë persona. Sipas jush, është i fryrë ky numër?*

**Haliti:** Nuk kam pasur asnjëherë evidencë të numrit të luftëtarëve, sepse unë nuk e kam pasur këtë detyrë. Prandaj nuk mund të them nëse kanë qenë 60 mijë veteranë, 10 mijë, 12 mijë apo 20 mijë siç po flitet. Shifrat janë të ndryshme, por mendoj se askush nuk po ia qëllon. Ajo që është shqetësuese, dhe që këtë shqetësim e kanë ngritur edhe mekanizmat ndërkombëtarë si FMN-ja dhe Ministria e Financave, është se ky trend i politikës në Kosovë, që të gjithë të bëhen veteranë të arsimit, veteranë të luftës, veteranë të kësaj apo të saj çështje, dhe që të gjithë të paguhen, do ta falimentojë shtetin. Kosova nuk e ka buxhetin e ShBA-së apo të Gjermanisë. Ky është një problem me të cilin Kosova do të ballafaqohet dhe buxheti i shtetit do të tkurret dhe do të ketë problem të funksionimit të shtetit.

**"Epoka e re":** *Me këtë çështje tani ka filluar të merret drejtësia. Kemi një draftakuzë, e cila thotë se rreth 19 mijë veteranë të UÇK-së këtë status e kanë fituar kundërligjshëm. A mund ta zgjidhë këtë çështje drejtësia?*

**Haliti:** Unë kam prirje t'i besoj drejtësisë, por mendoj se drejtësia apo prokuroria në Kosovë nuk mund ta zgjidhë këtë problem. Prokuroria duhet të përballet me secilin individ që mund të akuzohet për abuzim. Nëse dyshohen 19 mijë persona, atëherë duhet të merren në pyetje 19 mijë veta. Nëse duam ta nxjerrim një ligj tjetër është krejt tjetër gjë. Besoj se drejtësia duhet të shohë se si të zgjidhet problemi. Unë, t'ju them të drejtën, nuk besoj se prokuroria mund ta zgjidhë këtë problem.

**"Epoka e re":** *Atëherë si do të zgjidhet ky problem. Keni ndonjë ide?*

**Haliti:** Nuk kam ndonjë ide konkrete për këtë çështje, por do të thosha se e mira së mirës është të gjendet një rrugë. Nuk kam ndonjë formulë konkrete se si mund të zgjidhet, sepse sikur të kisha ndonjë formulë do ta thosha. Unë kam dalë kundër mënyrës së përcaktimit të rregullave në ligj për të qenë veteran dikush. Mendoj se gabimet janë bërë në hapat e parë kur është miratuar ligji për kategoritë e luftës, pastaj të tjerat vijnë njëra pas tjetrës.

**"Epoka e re":** *Kjo çështje ka marrë përmasa më të mëdha kur prokurori special, Elez Blakaj, i cili e ka përpiluar draftakuzën, ka dhënë dorëheqje me arsyetimin se ka qenë i kërcënuar. Pastaj kjo ka zgjuar reagimin e shoqërisë. Si e keni parë këtë veprim të tij?*

**Haliti:** Përzierja e Qeverisë në çështjet e drejtësisë gjithmonë krijon reagime, sepse reagimet vijnë prej atyre që e dinë se Qeveria nuk mund të përzihet në çështjet e drejtësisë. Pra, Qeveria duhet ta bëjë punën e vet dhe drejtësia të veten. Nuk e di se çfarë kërcënimesh ka pasur ish-prokurori, përveç atyre që kam lexuar diçka në medie. Mendoj se nuk është mirë të përzihemi tek organet e drejtësisë, ashtu siç nuk është mirë që drejtësia, gjyqësia dhe prokurori ta konsiderojnë veten të varur nga Qeveria. Në demokraci pushtetet janë të ndara. Ne kemi Ministrinë e Drejtësisë, por kjo nuk do të thotë se kjo ministri është mbi organet e drejtësisë. Pra, pushteti gjyqësor është i pavarur dhe duhet ta kryejë punën e vet. Ajo që më shqetëson është se shumë herë këto organe, ndoshta për arsye të ndryshme, nuk e kryejnë detyrën e vet.

**"Epoka e re":** *Së fundmi në profilin tuaj në "Facebook" keni postuar një poezi të Fan Nolit, e cila nga shumëkush është interpretuar si një mesazh drejtuar ish-komandantëve të UÇK-së?*

**Haliti:** Unë e kam nxjerrë në "Facebook" atë vetëm se më ka pëlqyer si poezi. Mendoj njësoj, ashtu siç shkruan në atë poezi, dhe kështu duhet të veprojmë të gjithë. Në qoftë se dikush është gjysmë, siç e thotë Noli, atëherë është mirë që ose të punojë dhe të bëhet i tërë ose të lëshojë rrugë.

**"Epoka e re":** *Pra ka qenë mesazh për të gjithë shoqërinë?*

**Haliti:** Ka qenë mesazh për secilin. Unë mund të them se ajo poezi është mesazh për mësuesin, për gazetarin, për deputetin, për ministrin, për prokurorinë, për veteranin, për pastruesin, për kryetarin e komunës dhe për asamblistin. Pra, është mesazh për të gjithë. Nëse kemi një profesion, atëherë duhet ta kryejmë detyrën që e kemi.

## Thaçi: Jo ndarje e shkëmbim territoresh, por korrigjim të kufirit



Prishtinë, 23 gusht - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka ritheksuar edhe një herë idenë e tij që në kuadër të procesit të arritjes së një marrëveshjeje finale në dialogun politik me Serbinë, të përmbyllet edhe çështja e korrigjimit të kufirit. Sipas tij, me këtë korrigjim Kosova nuk ndahet, por e vë brenda kufirit të saj një territor prej tri komunave, Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, që aktualisht ndodhet brenda kufijve të Serbisë. "Jo ndarje të Kosovës, por po shkëmbimit të territoreve, 'ky ishte qëndrimi realist dhe i guximshëm i presidentit Ibrahim Rugova në vitin 1994'. Ndërsa qëndrimi im sot si president i Republikës së Kosovës ka evoluar dhe është i qartë: jo ndarje, jo shkëmbim, po korrigjimit të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për ta mundësuar bashkëngjitjen e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Kosovën", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

## Shoqata e Prokurorëve: Blakaj s'ka shprehur asnjë kërcënim

**Prishtinë, 23 gusht (ER)** - Shoqata e Prokurorëve të Kosovës ka bërë me dije se ish-prokurori Elez Blakaj nuk ka shprehur asnjë shqetësim apo kërcënim që ka të bëjë me punën e tij. Sipas kësaj shoqate, deklarimet publike të prokurorit të dorëhequr janë për t'i mbuluar interesat e tij personale. "Deri më tani asnjë prokuror i sistemit prokurorial të Kosovës, duke përfshirë edhe ish-prokurorin Blakaj, nuk ka shprehur asnjë shqetësim, qoftë si kërcënim apo si ndikim në punën e tij të pavarur dhe të paanshme nga kushdo qoftë. Andaj, deklarimet publike për, kinse, kërcënimet dhe ndikimet brenda sistemit prokurorial, janë për t'i mbuluar interesat e tij personale apo të kujtdo tjetër", thuhet në këtë reagim.

Po ashtu, Shoqata e Prokurorëve të Kosovës "zotohet se do të reagojë më fuqishëm, duke kërkuar përgjegjësi nga prokurorët që me veprimet e tyre dëmtojnë imazhin e sistemit prokurorial, interesat e qytetarëve dhe institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës". Në këtë reagim kjo shoqatë shpreh shqetësim të madh për situatën e krijuar në sistemin prokurorial pas dorëheqjes së prokurorit special, Elez Blakaj, i cili po merrej me rastin e veteranëve. "Menaxhmenti i sistemit prokurorial nuk mund të degradohet nga qarqet e caktuara politike, apo individë të caktuar nga shoqëria civile, sepse kjo konsiderohet ndërhyrje e drejtpërdrejtë në punën e pavarur të sistemit prokurorial dhe tendencë për t'i dëmtuar hetimet në rastet e caktuara penale", thuhet në reagimin e shoqatës.

Reagimi i nënshkruar nga kryetari i kësaj shoqate, Haxhi Dërguti, bën të qartë se "Shoqata e Prokurorëve të Kosovës mbështet fuqishëm punën e çdo prokurori individualisht dhe të organeve menaxhuese të sistemit prokurorial, si dhe dënon çdo tendencë për ta denigruar përkushtimin e secilit prokuror në mënyrë individuale dhe kolektive, që është



plotësisht e papranueshme dhe nuk i ndihmon zbatimit të Ligjit në Republikës e Kosovës".

Qytetarë dhe shoqëria civile në Kosovë ditën e mërkurë kanë mbajtur një protestë duke kërkuar dorëheqjen e kryeprokurorit Aleksandër Lumezi, por i njëjti ka thënë se nuk do të dorëhiqet pavarësisht prej presionit publik.

# Ministri Bytyqi thotë se shkollat verore kanë rëndësi të veçantë në arsim

"Nxënësit tanë kanë nevojë për organizime të tilla me qëllim që të bashkëpunojnë, zhvillojnë aktivitete të përbashkëta, shkëmbejnë mendime dhe përvoja, mbi të gjitha të njihen dhe socializohen mes vete", ka thënë ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në ceremoninë e hapjes së Shkollës Verore me moton "Të mësojmë duke u argëtuar"



EPOKA E RE **Arbisa SHEFKIU**

**Prishtinë, 23 gusht** - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, bashkë me drejtoreshën e USAID-it në Kosovë, Lisa Mango, kanë marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së Shkollës Verore me moton "Të mësojmë duke u argëtuar", e cila po mbahet në ambientet e Gjimnazit "Xhevdet Doda" në Prishtinë, ku po marrin pjesë nxënës të përzgjedhur të kësaj shkolle dhe të Gjimnazit "Hajdar Dushi" të Gjakovës.

Ministri Bytyqi tha se e çmon organizimin e shkollave verore të cilat kanë një rëndësi të veçantë për faktin se janë organizime vullnetare, kanë një peshë shumë më të madhe sesa ato organizime të detyruara për të gjithë ne. "Nxënësit tanë vërtet kanë nevojë për organizime të tilla me qëllimin e parë që të bashkëpunojnë, zhvillojnë aktivitete të përbashkëta, këmbejnë mendime dhe përvoja, mbi të gjitha të njihen dhe socializohen mes vete", ka thënë ministri Bytyqi.

Në vazhdim ministri Bytyqi ka thënë se është i angazhuar që së bashku me ministren e Arsimit të Shqipërisë, Lindita Nikolla, të organizojnë një shkollë verore mbarëshqiptare. "Kemi nevojë që të këmbejmë përvoja dhe kultura të përbashkëta, praktika të përbashkëta, ku të rinjtë do të përfitonin njohuritë e duhura pa ndonjë vështirësi", është shprehur ai.

Ministri Bytyqi ka falënderuar organizatorët e kësaj shkolle verore, USAID-in dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për mbështetjen e këtij organizimi dhe për të gjitha format e mbështetjes që po i bën zhvillimit të arsimit në Kosovë, ndërsa nxënësve të shkollave "Hajdar Dushi" të Gjakovës dhe "Xhevdet Doda" të Prishtinës, pjesëmarrës në këtë ngjarje, u ka uruar sukses. Ai ka premtuar se MAShT-i do t'u qëndrojë gjithmonë pranë shkollave për të përkrahur iniciativa të tilla. Gjatë këtyre ditëve nxënësit pjesëmarrës do të përfitojnë njohuri në elektronikë, ndërmarrësi, edukim medial dhe teknologji muzikore.

## Kolegji ISPE ankohet në ENQA dhe EQAR për arsimin e lartë

**Prishtinë, 23 gusht** - Ashtu siç ishte paralajmëruar në konferencën për media të javës së kaluar, pas marrjes së opinioneve nga profesorët, studentët, ekspertët e fushës së arsimit të lartë dhe publiku i gjerë, Kolegji ISPE e ka përgatitur letrën për Rrjetin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR), në të cilën, siç thuhet në komunikatën e Kolegjit ISPE, "prezantohen fakte të reja për parregullsitë dhe shkeljet ligjore në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë nga ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim".

Kolegji ISPE konstaton se "pasojat që mund të vijnë nga kjo letër i bartin MAShT-i, ministri Bytyqi, pasi që ata për interesa të tyre kanë shkelur në vazhdimësi ligjin, duke dëmtuar Kolegjin IPSE, duke krijuar monopol për një Kolegj të caktuar". "Mënyra se si qeveriset sot MAShT-i dhe Agjencia e Akreditimit do të ketë pasoja afatgjata për sistemin e arsimit në Kosovë, pasi që institucioni më i lartë (MAShT) po krijon favore të vazhdueshme për një kolegj dhe disa oligarkë përreth tyre, ndërsa po i dëmton kolegjet e tjera, siç është rasti i ISPE-së, i cili të gjitha resurset i ka investuar në cilësinë në arsim", thuhet në komunikatën e Kolegjit ISPE.

Ndërkaq ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, kishte drejtuar akuza në adresë të Kolegjit ISPE për presionin që i kishte bërë MAShT-it. "Kolegjit ISPE i bëj thirrje të angazhohet për plotësimin e kushteve që parashihen me ligj dhe mos të bëjë presion as në Ministri, as në Këshill", kishte thënë ministri Bytyqi.



# Klinika e Gastroenterologjisë pajiset me videogastroskop dhe videokolonoskop

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 GUSHT - Pas më shumë se tri vjetëve të mungesës së pajisjeve për punë kualitative, pas angazhimeve të menaxhmentit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë, Klinika e Gastroenetroogjisë është pajisur me pajisjet moderne për punë.

Me rastin e dorëzimit të këtyre pajisjeve, dr. Zaim Gashi, drejtor i Klinikës së Gastroenetrologjisë, ka falënderuar ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili, dhe drejtorin e përgjithshëm të ShSKUK-së, Basri Sejdiu, për mbështetjen e vazhdueshme për këtë klinikë. "Pas shumë nevojave të mëdha dhe shumë kërkesash që janë bërë në të kaluarën keni reflektuar, keni pasur mirëkuptim dhe tani po shihet rezultati. Tani pacientët mund t'i kryejnë shërbimet këtu dhe nuk kanë nevojë që këto shërbime t'i kryejnë jashtë", ka thënë Gashi.

Ndërsa drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, ka thënë se janë në rrugën e drejtë që pacientët tanë t'i trajtojnë në institucionet tona publike. Ai ka thënë se në Klinikën e Gastroenetrologjisë është një staf i mrekullueshëm. "Pajisjet janë kompletuar dhe stafi i klinikës mund të punojë në të gjitha metodat endoskopike dhe metodat e tjera që i kanë në gastroenterologji. Në tre vjetët e fundit nuk ka pasur fare gastroskop dhe kolonoskop dhe tani stafi i klinikës e ka një aparaturë, ku përfitues më të mëdhenj do të jenë pacientët", ka thënë Sejdiu.



Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka premtuar se në sistemin e shëndetësisë do të rriten cilësia dhe siguria shërbimeve, si dhe do të shtohet dinamika e punës. "Ka tri vjet që Klinika e Gastrologjisë është në mungesë të një videogastroskopi dhe një videokolonoskopi për kontrollimin e zorrëve dhe të lukthit. Si pasojë, të gjithë qytetarët tanë që kanë pasur nevojë për trajtime të tilla janë orientuar në sektorin privat, duke shpenzuar mijëra euro. Sot ne ia dorëzuam një aparaturë të re dhe moderne kësaj klinike në mënyrë që qytetarët tanë të gjejnë trajtim aty. Me pajisjet e reja që do t'i blejmë edhe për klinikat e tjera do t'ua mundësojmë profesionistëve shëndetësorë ta përmbushin potencialin e tyre, në të njëjtën kohë ta ruajmë xhepin e qytetarëve. Kështu, do ta rritim cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve, si dhe do ta shtojmë dinamikën e punës", ka thënë Ismaili.

# Tryeza për dialogun Kosovë - Serbi e thirrur nga Bahtiri nxjerr pesë konkluzione

MITROVICË, 23 GUSHT (ER) - Në Mitrovicë të enjten është mbajtur tryeza lidhur me dialogun që po zhvillohet në Bruksel midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, të cilën e kishte ftuar kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri.

Në tryezë morën pjesë nënkryetari i parë i LDK-së, Agim Veliu, nënkryetari i parë i LV-së, Besnik Bislimi, nënkryetari i AAK-së, Ahmet Isufi dhe kryetari i Kuvendit të Përgjithshëm të AKR-së, Fatmir Matoshi.




Pas një diskutimi të gjerë e të frytshëm, ku qëndrimet lidhur me çështjet që u diskutuan ishin shumë të përafërta, pjesëmarrësit e kësaj tryeze lidhur me procesin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, njëzëri miratuan këto konkluzione: 1. Në dialogun që po zhvillohet në Bruksel nuk mund të ketë negociata për ndryshim të kufijve të Republikës së Kosovës dhe as për shkëmbimin e territoreve midis dy shteteve; 2. Asociacioni i Komunave të Kosovës me shumicë serbe nuk mund të formohet në kundërshtim me ligjet e Republikës së Kosovës dhe frymën e Kushtetutës sonë; 3. Është i domosdoshëm shqyrtimi dhe vlerësimi i procesit të deritanishëm negociator, duke u bazuar në raportin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbi arritjet dhe sfidat në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit; 4. Është e domosdoshme që Kuvendi i Republikës së Kosovës të hartojë një platformë të përbashkët negociatore që përfshinë kërkesat e shtetit të Kosovës ndaj Serbisë, më pastaj ta caktojë ekipin negociator; dhe 5. Ekipi negociator i aprovuar duhet t'i raportojë Kuvendit të Republikës së Kosovës pas çdo raundi të bisedimeve në Bruksel.

## Krimet kibernetike në rritje dhe sfidë për vendin

PRISHTINË, 23 GUSHT (ER) - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Selami Shkodra, në kuadër të vizitave të rregullta, të enjten ka vizituar Policinë e Kosovës, përkatësisht sektorin për hetimin e krimeve kibernetike që është i strukturuar në kuadër të Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar.

Gjatë këtij takimi zëvendësministri Shkodra ka ofruar mbështetjen e tij për sektorin e hetimit të krimeve kibernetike për luftimin e krimit kibernetik dhe dukurive të tjera që rrjedhin nga kërcënimet e sigurisë kibernetike, duke paraqitur edhe nevojën për ngritje të kapaciteteve teknike dhe profesionale për luftimin e këtyre dukurive në Republikën e Kosovës.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar, Rexhep Fetahu, dhe udhëheqësi i sektorit për hetimin e krimeve kibernetike, Fadil Abdyli, e njoftuan zëvendësministrin Shkodra për punën dhe angazhimin e dikastereve që udhëheqin në luftimin e këtyre dukurive, të cilat, bazuar në statistikat e paraqitura, janë në rritje e sipër dhe paraqesin një sfidë jo vetëm për vendin tonë.

Megjithatë, u tha se falë bashkëpunimit të mirë me shumë institucione ndërkombëtare janë duke u zgjidhur shumë raste në të cilat si mjet i kryerjes së veprave përdoret sistemi kompjuterik.



# Nënshkruhet marrëveshja për implementimin e ‘Programit për trajnimin në punë’

PRISHTINË, 23 GUSHT (ER) - Klubi i Prodhuesve të Kosovës (KPK) ka nënshkruar një marrëveshje të mirëkuptimit me Komunën e Kaçanikut për fillimin e implementimit të "Programit për trajnimin në punë", program ky i cili mbështetet financiarisht nga projekti i USAID, EMPOWER sektori privat, në partneritet me Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, Sida.
Programi për trajnimin në punë ka për qëllim t'i mobilizojë kompanitë në sektorin privat që të angazhohen në mënyrë më aktive për trajnimin e të rinjve ekonomikisht dhe aftësimin e tyre profesional. Për këtë arsye, KPK-ja së bashku me partnerët nga sektori privat ka filluar implementimin e këtij programi, i cili është i strukturuar për zhvillimin e aftësive profesionale tek të rinjtë dhe për rritjen e mundësisë së punësimit të tyre.
Në Komunën e Kaçanikut përfituesit e parë të këtij programi do të jenë të rinj, të cilët do të trajnohen në punë përmes angazhimit në kompani. Në përfundim të trajnimeve pritet që disa prej përfituesve do të kenë mundësi të punësohen në kompanitë partnere prodhuese të klubit.
Kandidatët do të përfitojnë nga një program trajnimi i kualifikuar dhe i strukturuar për nevojat e tregut të punës. Komunat e tjera përfituese nga ky program janë edhe Vitia, Gjilani dhe Hani i Elezit. Gjatë javëve në vazhdim Klubi i Prodhuesve të Kosovës do të njoftojë se kur do të hapen aplikimet për përzgjedhjen e kandidatëve në këto komuna.




# Kryetari i OEK-ut vizitoi kompaninë ‘Al Trade Center’



PRISHTINË, 23 GUSHT (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka vizituar të enjten kompaninë "Al Trade Center" si shenjë përkrahje për sektorin e ndërtimit. Rukiqi ka shprehur rëndësinë që ka sektori i ndërtimit në rritjen e vazhdueshme të punësimit në vendin tonë.
Gjatë kësaj vizite drejtori i "Al Trade Center", Sokol Gashani, ka vlerësuar lart punën e OEK-ut për mbështetjen e bizneseve në përgjithësi. Rukiqi ka shtuar se OEK-u do të jetë në përkrahje të vazhdueshme të sektorit ndërtimor për promovimin e vlerave dhe tejkalimin e problemeve me të cilat ballafaqohen kompanitë e ndërtimit.
Kryetari i OEK-ut ka vizituar edhe kompleksin afarist-banesor "Linda Premium Residence", projekt që menaxhohet nga "Al Trade Center". Kjo kompani, përpos sektorit ndërtimor, ka edhe sektorë të tjerë që veprojnë në qytete të ndryshme të Kosovës.

## Albena Reshitaj do ta udhëheqë Task Forcën për pastrimin e Kosovës

PRISHTINË, 23 GUSHT (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj me këshilltarët e vet ka diskutuar për organizimin e aksionit për pastrimin e mjedisit të Kosovës. Po ashtu, ai ka njoftuar se ish-ministrja e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, tani këshilltare e kryeministrit Haradinaj, Albena Reshitaj, do ta udhëheqë Task Forcën për Pastrim. "Duke marrë parasysh përvojën, përkushtimin dhe vullnetin e saj të treguar gjatë kohës sa ishte ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga sot Albena Reshitaj do të udhëheqë Task Forcën për Pastrimin e Kosovës si një nga ideatoret e kësaj nisme të rëndësishme që fillon më 15 shtator deri më 15 dhjetor. Së bashku, me një mobilizim gjithëpërfshirës, me përkrahjen edhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile, donatorëve ndërkombëtarë, do të krijojmë një Kosovë të pastër dhe evropiane", ka thënë Haradinaj.



# Hapet konkursi për drejtorë të bordeve për 14 ndërmarrje publike

Në katërmbëdhjetë ndërmarrje publike është hapur konkursi për drejtorë të bordeve. Konkursi është i hapur 30 ditë, nga data 22 gusht deri më 22 shtator. Një kandidat për t'u zgjedhur drejtor i Bordit në Ndërmarrje Publike Qendrore duhet të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

**Prishtinë, 23 gusht** - Më 22 gusht është hapur konkursi për drejtorë të bordeve për 14 ndërmarrje publike. Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (nga data 22 gusht 2018 deri më 22 shator 2018). Konkursi është i hapur për 14 ndërmarrje publike: Posta e Kosovës, Aeroporti i Gjakovës, Hekurudhat e Kosovës - InfraKos, Hekurudhat e Kosovës - TrainKos, NPH Ibër Lepenc, Kompania për Menaxhimin e Deponive, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Mitrovica, Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Radoniqi, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Prishtina, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor, Prizren, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidromorava, Gjilan, Kompania Rajonale e Ujësjellësit Hidrodrini, Pejë dhe Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë, Pejë.

Një kandidat për t'u zgjedhur drejtor i Bordit në Ndërmarrje Publike Qendrore duhet të ketë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në nivel të lartë të menaxhimit në fushat e poshtëshënuara: në administrim të biznesit, financa të korporatave, financa publike, menaxhim thesari, banka, biznes konsultimesh, industri ose të ketë qenë së paku për pesë vjet kontabilist i certifikuar, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i ndonjë profesioni tjetër që ndërlidhet me veprimtarinë afariste të ndërmarrjeve publike qendrore.

Një person nuk ka të drejtë të shërbejë si drejtor në Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore nëse: Ka qenë i dënuar dhe është nën hetime nga një gjykatë kompetente; ka shkelur kodin etik apo standardet e sjelljes profesionale, përveç nëse një dënim i tillë është ndryshuar nga një gjykatë ose organ tjetër i ankesave; nuk ka bërë përgënjeshtrime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim; ka qenë në post menaxhues të ndonjë kompanie që ka falimentuar gjatë dhjetë (10) vjetëve të fundit; nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për ndërmarrjet publike ku kandidati aplikon.

Përfaqësues të shoqërisë civile të cilët kanë realizuar hulumtime për emërimet në këto pozita në vazhdimësi kanë pohuar se ndërmarrjet publike janë të politizuara. Një dukuri e tillë i ka përcjellë të gjitha qeveritë e deritashme të Kosovës. Pothuajse në të gjitha ndërmarrjet qendrore publike dhe ato rajonale punësimi nuk realizohet në bazë të kritereve të kërkuara por, siç thonë monitoruesit nga shoqëria civile, emërohen anëtarë të partive politike nga subjektet që vijnë në pushtet.

# Valuta ruse shënon ulje




Moskë, 23 gusht - Valuta ruse, rubla, ka prekur më 23 gusht nivelin më të ulët në treg kundrejt dollarit amerikan në dy vjetët e fundit. Të enjten rubla ka rënë rreth 2 për qind, duke arritur shifrën 92 për 1 dollar amerikan mirëpo, pasi Banka Qendrore e Rusisë ka thënë se do të pezullojë blerjen e valutave të huaja, e njëjta është tregtuar për 68.3.

Banka Qendrore ka thënë se nuk do të blejë valuta të huaja deri në fund të muajit shtator për ta "ulur paqëndrueshmërinë në tregjet financiare". Zhvlerësimi i kësaj valute ka ardhur pas raportimeve të fundit se Shtetet e Bashkuara janë duke u përgatitur për sanksione të tjera kundër Moskës.

Më 21 gusht Uashingtoni ka vënë sanksione kundër dy kompanive ruse të transportit, pas dyshimeve se kanë bërë tregti të naftës me Korenë Veriore.

Presidenti rus Vladimir Putin i ka cilësuar sanksionet "joproduktive" pas negociatave që ka pasur me homologun finlandez Sauli Niinisto.

Në prill të vitit 2016 rubla ka shënuar rënie të ngjashme për shkak të rënies së çmimeve të naftës. Rusia është tejet e varur nga eksportet e karburanteve.

## ATK-ja fillon bashkëpunimin me Administratën e të Hyrave Publike të Maqedonisë

**Prishtinë, 23 gusht (ER)** - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, së bashku me bashkëpunëtorë, ka filluar takimin dyditorë në Administratën e të Hyrave Publike të Maqedonisë.

Përfaqësuesit e ATK-së janë pritur nga drejtoresha e përgjithshme e Administratës së të Hyrave në Maqedonisë, Sanja Kukarevska dhe ekipi i saj.

Në takim u diskutua për zhvillimet e fundit në dy administratat tatimore si dhe bashkëpunimin e deritashëm. Qëllimi i vizitës është shkëmbimi i përvojave për trajtimin e çështjeve specifike tatimore, të cilat priten t'i fuqizojnë kapacitetet operacionale.

Në takim u shkëmbyen edhe qëndrimet e dy administratave në pajtimin e një draftmemorandumi të bashkëpunimit, i cili pritet të nënshkruhet së shpejti.

Memorandumi i bashkëpunimit do ta mundësojë zgjerimin e bashkëpunimit në fushën e shkëmbimit të përvojave, bartjen e njohurive dhe praktikave të mira, të cilat ndikojnë në ngritjen e përmbushjes vullnetare dhe luftimin e evazionit tatimor.



# Formohen komisionet për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet në Suharekë

Suharekë, 23 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muahrremaj, ka bërë me dije se ka marrë vendim për formimin e komisioneve të cilat do të merren me vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet. "Kam vendosur për formimin e komisioneve për të dalë në terren për t'i parë dhe për t'i vlerësuar dëmet e shkaktuara. Sot u formuan komisionet për disa fshatra dhe për qytet, ndërsa nesër (e premte) mbahet takimi për formimin e komisioneve të tjera për fshatrat e mbetura", ka thënë Muahrremaj. Qeveria e Kosovës ka ndarë 1.1 milion euro për t'i dalë në ndihmë kësaj komune, pasi vërshimet që kanë ndodhur para disa ditësh kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme.





# Fillojnë punimet për hapjen e pikës kufitare Stanqiq - Bellanoc

Gjilan, 23 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka marrë pjesë në hapjen e punimeve për ndërtimin e pikës kufitare Stanqiq - Bellanoc e cila do të financohet nga Komisioni Evropian. Me këtë rast, ai ka thënë se kjo pikë kufitare i jep dimension zhvillimor Gjilanit dhe Grykës së Karadakut. "Me këtë projekt Gryka e Karadakut dhe Gjilani merr dimension krejt tjetër, zhvillimor, infrastrukturor, në veçanti zhvillohet bujqësia dhe turizmi malor. Janë projekte që ne do t'i atraktojmë edhe me bashkatdhetarët tanë dhe investitorët e huaj, në mënyrë që kjo zonë të jetë më e zhvilluar. Hapja e pikës kufitare Stanqiq - Bellanoc është projekti më i madh në Grykën e Karadakut. Kjo pikë Kosovës ia mundëson që përmes korridorit të dytë ndërkombëtar të lidhet me korridorin e dhjetë, autostradën Shkup - Selanik. Për ne është me interes lidhja e shqiptarëve të Kosovës me ata të Kumanovës", ka thënë Haziri. Ai ka theksuar se nga mbikëqyrësi i punimeve është njoftuar se projekti është në revidim për shkak të jostabilitetit të tokës, por pritet teknikisht të zgjidhet nga Komisioni Evropian. "Shpresoj shumë t'i japin dinamikë sipas kalendarit për ta mundësuar lëvizjen për qytetarët, natyrisht edhe për mallrat", ka deklaruar Haziri.



# Diplomacia ekonomike prezantohet në Malishevë

Malishevë, 23 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka pritur në takim zëvendësministrin e Punëve të Jashtme, Besnik Hotin, drejtorin e Departamentit për Diplomaci Ekonomike, Guner Ureya, dhe zyrtarin për Integrime Ekonomike, Turkesh Dalifi, me të cilët kanë biseduar për projektin e ministrisë për diplomacinë ekonomike. Hoti e ka njoftuar kryetarin Begaj për projektin e kësaj ministrie për diplomacinë ekonomike dhe integrimin ekonomik të Kosovës.

Ndërsa drejtori i Departamentit për Diplomaci Ekonomike, Guner Ureya, e ka sqaruar në tërësi projektin e MPJ-së, rëndësinë që ka ky projekt në raport me zhvillimin ekonomik të vendit dhe ndikimin e rëndësinë e nivelit lokal.

Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i ka njoftuar zyrtarët e MPJ-së me kapacitetet që ka kjo komunë, sidomos në fushën e bujqësisë, turizmit, si dhe rreth kushteve të mira që ofron për investitorët që duan të investojnë. Gjatë këtij takimi Begaj dhe zyrtarët e MPJ-së janë pajtuar për bashkëpunim të ndërsjellë me qëllim të promovimit të ofertës së Komunës së Malishevës në raport me investitorët e mundshëm.

# 200 familje me asistencë sociale në Skenderaj përfitojnë mish

Skenderaj, 23 gusht (ER) - Dyqind familje nga Komuna e Skenderajt që shfrytëzojnë asistencën sociale kanë qenë përfituese të ndihmës së radhës nga Shoqata "Jetimët e Ballkanit", e cila udhëhiqet nga hoxha Halil Kastrati. Falë ndihmës dhe mbështetjes së kësaj shoqate për familjet nevojtare të Skenderajt, të enjten në Qendrën për Punë Sociale u janë shpërndarë nga pesë kilogramë mish 200 familjeve që janë në listën e përfituesve të asistencës sociale.

Përfituesit janë shprehur të kënaqur me këtë ndihmë, duke e vlerësuar kontributin e Shoqatës "Jetimët e Ballkanit" dhe të Komunës së Skenderajt. Me këtë rast, Komuna e Skenderajt ka falënderuar Shoqatën "Jetimët e Ballkanit", e udhëhequr nga hoxha Halil Kastrati, si dhe qumështoren "Drena" në Skenderaj me pronar Rrustem Rukolli që ka ndihmuar transportin e mishit nga qyteti i Prizrenit deri në Skenderaj.



## Qeveria ndan fond emergjent për Komunën e Mamushës



**Mamushë, 23 gusht (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Mamushës, Abdulhadi Krasniq, dhe deputetët nga Partia Demokratike Turke e Kosovës, Fikrim Damka dhe Mufera Shinik, që janë pjesë e Grupit Parlamentar 6+ në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në këtë takim është biseduar për të arriturat në komunë, për investimet në infrastrukturë, për zhvillimin ekonomik dhe për prioritetet e qeverisë për përkrahje të bujqve të Komunës së Mamushës.

Kryeministri Haradinaj është njoftuar nga kryetari Krasniq për dëmet që u janë shkaktuar ekonomive familjare dhe bujqve të Mamushës nga reshjet e shiut. "Kemi marrë obligimin që sikur edhe për komunat e tjera të prekura nga vërshimet, ashtu edhe për Mamushën të ndajmë një fond emergjent, kurse për dëmet e tjera në infrastrukturë dhe biznese Qeveria do t'i marrë obligimet e veta në bazë të vlerësimit të ekspertëve të komunës, Ministrisë së Bujqësisë dhe asaj të Infrastrukturës", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Kryetari i Komunës së Mamushës, Abdulhadi Krasniq, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për gatishmërinë e tij dhe të Qeverisë për ta mbështetur komunën e Mamushës.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka takuar ekipin punues për hartimin e Projektligjit për Trashëgimi Kulturore

# Gashi kërkon të mbrohet me ligj trashëgimia kulturore

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore mbetet në vazhdimësi prioritet i tij. Ai ka kërkuar nga ekipi punues të ketë bashkëpunim me shoqërinë civile dhe me organizatat ndërkombëtare në mënyrë që të kemi një ligj në të cilin janë konsultuar të gjitha palët



EPOKA E RE Arbisa SHEFKIU

**Prishtinë, 23 gusht** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur të enjten në kabinetin e vet anëtarët e ekipit punues për hartimin e Projektligjit për Trashëgimi Kulturore. Ky takim vjen pas miratimit të konceptdokumentit për trashëgimi kulturore nga Qeveria e Kosovës dhe emërimit të këtij ekipi me vendim të sekretarit të përgjithshëm të MKRS-së.

Ministri Gashi ka përgëzuar grupin punues për punën dhe i ka ofruar mbështetje të vazhdueshme duke u zotuar të punojë bashkërisht për ta finalizuar hartimin e Projektligjit për Trashëgimi Kulturore. "Sot takova ekipin punues për hartimin e Projektligjit për Trashëgimi Kulturore, i cili është përgjegjës të punojë për hartimin e Projektligjit për Trashëgimi Kulturore. Është takimi i parë i ekipit punues për hartimin e Projektligjit për Trashëgimin në kuadër të planifikimeve tona për avancimin e infrastrukturës ligjore duke pasur parasysh se ligji aktual nuk i plotëson kërkesat e kohës dhe duhet të punojmë që ta shtyjmë përpara këtë ligj", ka thënë Gashi.

Nga ekipi punues, ministri Gashi ka kërkuar të ketë bashkëpunim me shoqërinë civile dhe me organizatat ndërkombëtare në mënyrë që të kemi një ligj në të cilin të ka konsultuar të gjitha palët. "Përkushtimi im si ministër i MKRS-së ka qenë dhe mbetet përmirësimi i kushteve të punës, investimi në institucionet e kulturës, por edhe ngritja e performancës institucionale dhe pasurimi i jetës kulturore dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore në vendin tonë", është shprehur ai.

Ministri Gashi ka theksuar se plotësimi dhe avancimi i kornizës ligjore dhe infrastrukturore konform praktikave dhe standardeve ndërkombëtare mbetet një ndër prioritetet e tij si ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Për hartimin e Projektligjit për Trashëgimi Kulturore, ministri Gashi u shpreh se është një ndër masat e shumta legjislative dhe zbatuese në fushën e trashëgimisë kulturore që koincidon edhe me fillimin e vitit evropian. "Trajtimi i trashëgimisë kulturore duhet bërë në mënyrë të integruar, si trashëgimia arkitekturale, trashëgimia shpirtërore, ajo arkeologjike, peizazhet kulturore si dhe të gjitha asetet nën mbrojtje të shtetit duhet të mbrohen, ruhen, studiohen e promovohen sa më shumë dhe të bëhen objekte të hartës turistike të Republikës së Kosovës. "Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore mbetet në vazhdimësi prioritet i imi si ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës si sektor i veçantë, me rol kyç në zhvillimin e shtetit", ka thënë ministri Gashi.

Ndërkaq anëtarët e ekipit punues u zotuan se do të jenë të përkushtuar maksimalisht që të punojnë deri për finalizimin e hartimit të Projektligjit për Trashëgiminë Kulturore.

## Begaj premton mbështetje më të madhe për OJQ-të



**Malishevë, 23 gusht (ER)** - Në vazhdën e takimeve, të dëgjimeve publike për hartimin e projekteve për vitin 2019, të enjten zyrtarët e Komunës së Malishevës kanë zhvilluar debat me OJQ-të.

Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, në fjalën e tij ka thënë se në vitet e ardhshme do të investojë më shumë në OJQ, me qëllim të integrimit të të rinjve malishevas që të përvetësojnë shkathtësi dhe kompetenca nga projektet që do t'i ofrojnë. "Ne do t'i mbështesim të gjitha ato OJQ që ofrojnë projekte të cilat ndikojnë në zhvillimin dhe aftësimin e të rinjve për punësim, për vlerat kulturore, sportive, pasi Malisheva ka infrastrukturën e duhur dhe funksionale", ka thënë kryetari Begaj.

Edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, ka inkurajuar përfaqësuesit e OJQ-ve të jenë më aktivë me projektet e tyre dhe të bashkëpunojnë mes vete. "Kështu ju do ta vëni në lëvizje edhe më të madhe komunën. Mos pritni që komuna t'ju vë në lëvizje, por ne ju mbështesim në bazë të projekteve që aplikoni", është shprehur Berisha.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Valon Mazreku, e ka paraqitur buxhetin e ndarë për Komunën e Malishevës për vitin 2019, me theks të veçantë për investimet kapitale dhe ka kërkuar nga organizatat joqeveritare që përmes propozimeve të tyre dhe komunës ta orientojnë investimin e 4.3 milionë eurove në projektet më të rëndësishme për qytetarët.

Gjatë debatit OJQ-të e Malishevës kanë kërkuar të rriten subvencionet me arsyetimin e kërkesave dhe nevojave të tyre për t'i zhvilluar aktivitetet, pasi kostoja e tyre është shumë e lartë.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Valon Mazreku, ka thënë se kjo kategori për vitin e ardhshëm do të ketë ngritje buxhetore.

# Një libër tejet i veçantë për të drejtat pronësore në Kosovë



Prof. dr. Abdullah KARJAGDIU

Kohë më parë doli në dritë libri me titull "E drejta në pronë (Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut)". Ky vëllim është një nismë e sponsorizuar nga USAID-i për t'i përkrahur të drejtat pronësore bashkëkohore në Kosovë. Në të vërtetë, ky libër është një përmbledhje e vendimeve kryesore të Gjykatës Evropiane lidhur me të drejtat pronësore, në mënyrë që gjykatësit, avokatët dhe politikbërësit në Kosovë të mund të njoftohen me këtë përmbledhje të rëndësishme të rasteve ligjore që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë. Rëndësia e veçantë e këtij vëllimi konsiston në faktin se Kosova përballet me shumë sfida për të siguruar të drejtën në pronë, ngaqë baza ligjore që rregullon të drejtat pronësore në Kosovë është e vjetruar, jokonsitente, e vagullt dhe konfuze, marrë parasysh që në Kosovë është përhapur informaliteti në sektorin pronësor, pronat e ish-pronarëve të konfiskuara, nacionalizuara dhe eksproprijuara nuk janë kthyer dhe kompensuar, ndonëse kanë kaluar 10 vjet nga pavarësia, personat e zhvendosur vazhdojnë të ballafaqohen me sfida në ushtrimin e të drejtave të tyre në pronë dhe që, për shkak të qëndrimeve mbizotëruese shoqërore në Kosovë, shumë gra heqin dorë nga trashëgimia e tyre dhe nga zotërimi i pronës.
Një çështje me interes shumë të madh për Kosovën në këtë vëllim janë edhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për kthimin dhe kompensimin e pronave të konfiskuara, nacionalizuara dhe eksproprijuara pas Luftës së Dytë Botërore në vende të ndryshme të Ballkanit dhe Evropës, meqë dihet se, gjatë periudhës 1945-1999, autoritetet serbe hegjemoniste nëpërmjet politikave shtetërore, me qëllim të kolonizimit të Kosovës dhe përmes akteve përcjellëse juridike, i kanë konfiskuar, nacionalizuar dhe eksproprijuar pronat, me ç'rast kryesisht i kanë diskriminuar dhe dëmtuar rëndë shqiptarët autoktonë, që kanë luftuar, rezistuar dhe rënë dëshmorë për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e trojeve shqiptare. Konfiskimet e pasurive të shqiptarëve në Kosovë autoritetet serbe i kanë aplikuar me qëllim të përndjekjeve të planifikuara të familjeve të aktivistëve politikë, luftëtarëve dhe dëshmorëve të kombit të rënë pas Luftës së Dytë Botërore. Këto prona në disa raste madje janë marrë edhe pa kurrfarë gjyqi apo janë grabitur, ndërsa në mjaft raste edhe përmes proceseve gjyqësore të kurdisura, ashtu që patriotë dhe luftëtarë dhe dëshmorë të spikatur, apriori, janë stigmatizuar arbitrarisht si "armiq të shtetit jugosllav" dhe, si të tillë, edhe familjet e tyre janë njollosur dhe janë privuar nga e drejta për punë, shkollim, pronë dhe janë persekutuar penalisht dhe të njëjtëve u është konfiskuar pasuria ose janë dëbuar në Turqi.
Së këtejmi, pikërisht ky libër jep sqarime dhe udhëzime të qarta, efikase dhe tejet të dobishme se si duhet të zgjidhen çështjet pronësore nga gjykatat e Kosovës. Kështu, lidhur me këtë çështje, hartuesit e kësaj përmbledhjeje voluminoze sqarojnë se, ndonëse gjykatat e Kosovës refuzojnë kategorikisht që t'i kthejnë pronat e konfiskuara, nacionalizuara dhe eksproprijuara gjatë viteve 1945-1999 dhe megjithëse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, ligjvënësit në Kosovë përmes përfshirjes në Kushtetutë të disa konventave, ndër të tjera edhe Konventën Evropiane, i ka bërë këto konventa dhe protokollet shtesë të tyre obligative për gjykatat e Kosovës. Kjo ngaqë Kushtetuta e Kosovës siguron që Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale dhe Protokolleve të tyre kanë efekt ligjor të drejtpërdrejtë në Kosovë, me prioritet mbi ligjet e tjera në Kosovë (Neni 22) dhe së këndejmi institucionet dhe gjykatat e Kosovës mund dhe duhet ta interpretojnë këtë Konventë në pajtim me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykatës Evropiane) (Neni 53). Prandaj, është koha e fundit që gjykatat tona të marrin vendime të ndershme, të drejta, legale, ligjore dhe në pajtim të plotë me Kushtetutën e vendit dhe me të gjitha konventat bashkëkohore, që janë të integruara në Kushtetutën e vendit tonë, dhe të fillojnë kthimin dhe kompensimin e pronave të konfiskuara, nacionalizuara dhe eksproprijuara në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore.




# U mbajt Kongresi i Parë i Republikës së Çamërisë



Nga: Behram HOTI,
*veprimtar i kauzës gjithëkombëtare shqiptare*

Sot (e shtunë, datë 14. 7. 2018, Sarandë, Shqipëri), u mbajt Kongresi i Parë i Republikës së Çamërisë. Në këtë kongres morën pjesë mbi 255 delegatë nga të gjitha vatrat atdhetare të Shqipërisë, Kosova Lindore (Medvegjë, Bujanoc, Preshevë), Tetovë, Shkup, Kumanovë, Shkodër, Tropojë, Prizren, Gjakovë, Deçan, Pejë (Dukagjin), Mitrovicë, Shalë Bajgore, Llap, Gollap, Skenderaj, Drenas, Vushtrri, Prishtinë (Drenicë), Janinë, Gjirokastër, Durrës, Zadrime, Dibër.
Në panelin e kongresit prezantonin dy kongresmenë, me seli në Bruksel, (z. Junger dhe Petra Kristina Kepther) që kanë merita të veçanta për sensibilizimin e çështjes çame në Parlamentin Evropian në Hagë dhe në shpalljen dhe përkrahjen e Republikës së Çamërisë. Fillimisht punën e kongresit, delegatët dhe masën e popullatës (mbi 400) e përshëndeti z. Festim Lato nga Holanda, president i Republikës së Çamërisë.
Me një fjalë rasti, para delegatëve dhe masës folën z. Ali Aliu, kryeministër i Republikës së Çamërisë, Erena Koseçi - kryeparlamentare (kryetare e Kuvendit) të Republikës Çame, si dhe Selam Berisha, kryetar i Ballit Kombëtar (Republika e Kosovës), prof. Rexhep Abazi, veprimtar i Kosovës Lindore (Medvegjë, Bujanoc, Preshevë), pjesëtari i familjes Bajraktari, Hotit (Skenderaj).

## Kronologji e Qeverisë së Republikës së Çamërisë

Qeveria e Republikës së Çamërisë është njohur nga Parlamenti Evropian dhe Gjykata Ndërkombëtare. Më datën 11 shkurt 2016 u bë dorëzimi i dosjes së Çamërisë. Kjo dosje parashtroi katër kërkesa: Njohjen e gjenocidit grek të viteve 1944-1945 ndaj popullatës çame; Kthimin e popullsisë çame në trojet e veta në Çamëri; Dëmshpërblimin nga shteti grek që nga momenti i gjenocidit; Lirimin e tokës me sipërfaqe prej 17.500 km të zotëve të vet, çamëve.
Më datë 30 tetor 2016 u mblodh Kuvendi i Përfaqësuesve të Çamërisë dhe shpalli Pavarësinë e Çamërisë.
Më datë 9 shtator 2017 u bë edhe njohja e Republikës së Çamërisë.
President i Republikës së Çamërisë u zgjodh Festim Lato.
Më datë 30 tetor 2017 u kremtua njëvjetori i shpalljes së Republikës së Çamërisë.
Qeveria e Çamërisë ka formuar edhe forcat e armatosura të Republikës me të cilat do të aderojë edhe në NATO.

*Sarandë, 14. 7. 2018*



E rrallë

# Në Spanjë ka më shumë derra se njerëz



Për herë të parë në Spanjë po ndodhë diçka e pazakontë. Sipas shifrave zyrtare të publikuara nga Ministria e Mjedisit, janë 50 milionë derra dhe 46.5 milionë njerëz, në vendin i cili është i njohur për mish derri. Shifrat tregojnë një rritje prej nëntë milionë krerësh që nga viti 2013 dhe këto të dhëna janë shqetësuese për ndikimet në mjedis të kësaj veprimtarie, thonë ekspertët e ambientit.

FOTO E DITES



Djemtë arabë dhe izraelitë hidhen në detin Mesdhe nga muri i lashtë që rrethon qytetin e vjetër të portit të Akrit në Izrael. /AP/

E jashtëzakonshme

# Vietnam, një krijesë misterioze zbulohet në plazh



Kafshë apo çfarë? Studiuesit janë duke hetuar imazhet e një zbulimi të çuditshëm të ndodhur në një plazh në Vietnam, në provincën Kien Giang. Një guitë turistike është përballur me një krijesë misterioze, e ngjashme me një algë, por me tentakula që të kujtojnë ato të një oktapodi. Mes hipotezave, është edhe ajo e një specieje të panjohur.

## BARSOLETA E DITËS



**I lutet djali babit:**
**- Babi, të lutem ma blej një fyell!**
**Babai i thotë:**
**- Jo djali jem, se na bën zhurmë e s'na lë të flemë.**
**- Po hajt bre babi, se i bie pra kur të flini.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit
në ora 16:00

### " INCREDIBLES 2" 3D



I Animuar/Aksion/Aventure; 1 ore 58 min

**Rolet:** Holly Hunter, Craig T. Nelson, Sarah Vowell, Huck Milner, Samuel L. Jackson, etj.

**Regjia:** Brad Bird

Në ora 18:20

### "FUTURE WORLD"



I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

**Rolet:** James Franco, Suki Waterhouse, Milla Jovovich, Lucy Liu, Jeffrey Wahlberg, Snoop Dog, etj.

**Regjia:** James Franco

Në ora 20:00

### "ANT-MAN AND THE WASP" 3D



Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 58 min

**Rolet:** Paul Rudd, Evangeline Lilly, Michael Pena, Michael Douglas, Michelle Pfeiffer, Laurence Fishburne, etj.

**Regjia:** Peyton Reed

Në ora 22:00

### "LOVING PABLO" (R)



Biografi/Krim/Drame; 2 ore 03 m

**Rolet:** Javier Bardem, Penélope Cruz, Peter Sarsgaard, etj.

**Regjia:** Fernando León de Aranoa

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Jeni duke u marrë me disa projekte paralele, kështu që mos humbni vëmendjen me gjëra të tjera që nuk janë në interesin tuaj për momentin.



**DEMI**
Nuk doni të hiqni dorë nga planet që keni bërë për sot, kështu që do të impenjoheni që gjithçka të shkojë sipas variantit tuaj.



**BINJAKËT**
Neglizhenca e disa çështjeve praktike sot mund të vënë në rrezik gjithçka keni organizuar deri më tani. Duhet t'i sqaroni keqkuptimet.



**GAFORRJA**
Nëse zgjoheni herët sot, do ta merrni ditën me më optimizëm dhe do të arrini të zgjidhni çdo problem që mund t'ju dalë përpara.



**LUANI**
E rëndësishme është të jeni vetvetja dhe kjo nuk do të thotë të përshtateni me të tjerët dhe të mundoheni ta ndryshoni karakterin tuaj.



**VIRGJËRESHA**
Keni zgjedhur një mënyrë disi të pazakontë veprimi dhe kjo nuk është në natyrën tuaj. Do t'i habisni personat pranë jush.



**PESHORJA**
Keni ndjekur një këshillë të gabuar që ju dhanë dhe tani jeni penduar. Ju ishit nisur në mirëbesim, por të tjerët përfituan.



**AKREPI**
Qëllimet tuaja janë të dukshme nga të tjerët, kështu që askush nuk do të zihet në befasi nga ato që mendoni ose bëni.



**SHIGJETARI**
Vërtet mund të keni gabuar në të kaluarën, por kjo nuk do të thotë se do të vazhdoni ta përsërisni. Ata që ju mbështesin nuk do ta vënë re këtë detaj.



**BRICJAPI**
Ndonjë çështje e vogël e pazgjidhur mund t'ju irritojë shumë sot. Duke parë dhe gjendjen tuaj të ndjeshme këto kohë, do të përjetoni mjaft stres.



**UJORI**
Megjithëse dita e sotme do të ketë ulje-ngritje humori, nëse do të merrni një sjellje pozitive, çdo gjë do të kthehet në favorin tuaj.



**PESHQIT**
Sot mund ta shfrytëzoni qetësisht kohën tuaj të lirë, duke biseduar me një mik ose duke ftuar dikë që nuk e shihni prej kohësh për drekë.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| NANCY - NIORT | 1 | GETAFE - EIBAR | 1 | BRESCIA - PERUGIA | 1 |
|---|---|---|---|---|---|

# Berisha: E mposhtim edhe Llapin

Ish-lojtari më i mirë në Kosovë, Visar Berisha, që ka bërë karrierë edhe në futbollin zviceran, ka thënë se Ballkani do të mposhtë në fundjavë skuadrën e Llapit. "Ndeshjes ndaj Llapit do t'i qasemi seriozisht dhe synim e kemi t'i marrim tri pikët e plota. Ekipi është i kompletuar dhe atmosfera është mjaft e mirë. Jemi duke punuar me intensitet të lartë që ta nisim mirë edhe ndeshjen e parë si vendës. Presim një numër të madh të 'Xhebrailave'", ka thënë Berisha

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 GUSHT - Mbrojtësi i KF Ballkani, Visar Berisha, është shumë i lumtur se skuadra e tij u rikthye në elitë me fitore. Skuadra nga Suhareka në ndeshjen e parë e mposhti Lirinë në Prizren (0-1). "Ndeshja me Lirinë ishte një derbi lokal dhe ne e kishim përgatitur ndeshjen në detaje duke e ditur se jemi duke u përballur me një ekip me përvojë, por ne besuam në forca dhe cilësi tona. Loja ishte e dominuar tërësisht nga ne si me raste ashtu edhe me kontroll të lojës dhe në fund na u shpërblye mundi", ka thënë Berisha.



Ndeshjen e radhës skuadra e Ballkanit e zhvillon si vendës kundër Llapit, kurse lidhur me këtë ndeshje sulmuesi i Llapit, Fiton Hajdari, ka paralajmëruar se futbollistët e Bylbyl Sokolit synojnë rezultat pozitiv. "Ndeshja ndaj Ballkanit do të jetë shumë e vështirë, por ne jemi duke u përgatitur për këtë përballje dhe mendoj se do të marrim rezultat pozitiv", ka deklaruar Hajdari. Atij i është kundërpërgjigjur Visar Berisha, i cili është i bindur se tri pikët e plota do t'i takojnë skuadrës së Ballkanit. "Jemi ekip i ri në Superligë, por me ambicie të larta për pjesën e epërme të tabelës. Ndeshjes ndaj Llapit do t'i qasemi seriozisht dhe synim e kemi t'i marrim tri pikët e plota. Ekipi është i kompletuar dhe atmosfera është mjaft e mirë. Jemi duke punuar me intensitet të lartë që ta nisim mirë edhe ndeshjen e parë si vendës. Presim një numër të madh të 'Xhebrailave'", ka deklaruar ai.

Visar Berisha është një nga mbrojtësit më të mirë të pasluftës në futbollin e Kosovës. Ai në kohën kur ishte pjesë e Prishtinës e fitoi epitetin e lojtarit të vitit në Kosovë dhe më pas u transferua në Zvicër ku nuk mundi ta shfaqë gjithë potencialin për shkak të problemeve me lëndime. Kampionatin e kaluar luajti për Drenicës dhe në afatin kalimtar të janarit, pas një oferte bindëse nga Ballkani, vendosi të rikthehet në këtë klub për ta udhëhequr në rikthimin në elitë.

# MKRS-ja: Prishtina - Drenica zhvillohet në stadiumin 'Fadil Vokrri'

PRISHTINË, 23 GUSHT (ER) - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit njofton opinionin publik rreth dilemave të cilat janë ngrehur ditët e fundit rreth moszhvillimit të ndeshjes në mes të KF Prishtina dhe KF Gjilani.

Ministria e Sportit është investitorja kryesore në këtë projekt, i cili konsiderohet i papërfunduar dhe, sipas të dhënave të organit mbikëqyrës, ky projekt do të pranohet teknikisht vetëm pas raportit përfundimtar të UEFA-s. Pas pranimit të këtij raporti, palët e përfshira në këtë proces (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Ambientit, Komuna e Prishtinës, Federata e Futbollit të Kosovës dhe punëkryesi) do t'i fillojnë procedurat e pranimit teknik të stadiumit. "Para disa ditësh është zhvilluar ndeshja e parë testuese në mes të KF Prishtina dhe KF Drita për Superkupën e Kosovës, ndeshje kjo e organizuar nga ana FFK-së e cila është monitoruar nga ana e zyrtarëve të UEFA-s. Indikacionet e para të zyrtarëve të UEFA-s janë që stadiumi i Prishtinës 'Fadil Vokrri' i plotëson kriteret e UEFA-s si stadium i kategorisë IV, andaj ky është një lajm pozitiv për institucionet, sportin dhe sportdashësit në vendin tonë, sepse Kosova përfundimisht për herë të parë do t'i zhvillojë ndeshjet në stadiumin e rinovuar i cili mban emrin e legjendës së futbollit Fadil Vokrri", thuhet në njoftimin e MKRS-së.




Ministri Kujtim Gashi ka deklaruar se pasi të bëhet pranimi teknik dhe certifikimi nga UEFA, stadiumi do t'i dorëzohet Komunës së Prishtinës si pronare, e cila pastaj do të vendosë për të gjitha procedurat e menaxhimit, kujdesin, por edhe për mënyrën e shfrytëzimit të tij. MKRS-ja dhe ministri Gashi ka qenë i përkushtuar që nga dita e parë e marrjes së detyrës që ta bëjë realitet përfundimin e të gjitha punimeve në stadiumin e Prishtinës "Fadil Vokrri" si një ndër projektet më kapital për përmirësimin e infrastrukturës sportive në vendin tonë.

MKRS-ja ka njoftuar se pas takimit që është mbajtur të enjten në mes të ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, kryetarit të Prishtinës, Shpend Ahmeti dhe kryetarit të Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, palët janë pajtuar që ndeshja në mes të KF Prishtina dhe KF Drenica, e paraparë për 2 shtator, të luhet në stadiumin "Fadil Vokrri", ndeshje kjo e cila do të shërbejë edhe si lojë e dytë testuese para lojës që do ta zhvillojë reprezentacioni i Kosovës në stadiumin "Fadil Vokrri".

## Shpëtim Idrizi pensionohet në ndeshjen Trepça '89 - Prishtina

MITROVICË, 23 GUSHT (ER) - Kapiteni i Trepçës '89, Shpëtim Idrizi, do të pensionohet nga futbolli aktiv në ndeshjen derbi që skuadra e '89-shit e zhvillon me Prishtinën në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë. "Shpëtimi që në moshën 17-vjeçare debutoi në KF Trepçën '89 dhe nga edicioni 1999/2000 e deri në ditët e sotme të edicionit 2018/2019 ishte futbollist standard dhe zhvilloi në total 665 ndeshje kampionale dhe për Kupën e Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Mitrovica.

89-shi ndihet krenar me faktin se Idrizi edhe pas shumë ofertave joshëse nga klubet në Kosovë dhe Shqipëri nuk e braktisi klubin, duke i qëndruar besnik përplot 20-vjet. Ai ishte kapiten i Trepçës '89 nga viti 2009 dhe gjatë karrierës së tij të bujshme ishte shembull për të mirë, angazhim dhe sjellje të jashtëzakonshme brenda dhe jashtë fushës së gjelbër.

Krahas futbollit, Shpëtim Idrizi ka arritur të diplomojë në Fakultetin e Shkencave të Edukatës Fizike dhe mban titullin e profesorit të Edukatës Fizike, derisa kontributi i tij te KF Trepça '89 lidhet edhe me trofetë të cilët i ka klubi gjatë periudhës sa kapiteni ishte pjesë e klubit: Edicioni 2011/2012 Kupa dhe Superkupa, edicioni 2016/2017 Kampion dhe Superkupa dhe gjashtë herë nënkampion. Pas ndeshjes lamtumirëse, kryesia e klubit ka vendosur që Idrizi të emërohet trajner i ekipit të juniorëve dhe asistent i shtabit teknik.



## Çani prish kontratën me Partizanin, transferohet në Itali

TIRANË, 23 GUSHT - Edgar Çani është larguar zyrtarisht nga Partizani. Sulmuesi 29-vjeçar ka ndërprerë kontratën me të kuqtë, kundrejt një shume e cila nuk është bërë ende publike. Sulmuesi u bë pjesë e Partizanit përgjatë sezonit 2017-2018, por pa arritur të përshtatet duke rezultuar një dështim. Më në fund mes palëve është gjetur marrëveshja për ta lënë futbollistin të lirë. "Panorama Sport" mëson ekskluzivisht, se pas largimit nga Partizani, Çani do të kalojë në Itali te skuadra e Viboneses, e cila militon në Serinë C. Sulmuesi do të rikthehet kështu në futbollin italian, pas një sezoni për t'u harruar në Kategorinë Superiore. Lajmin për prishjen e kontratës e ka bërë publik edhe klubi kryeqytetas nëpërmjet njoftimit në faqen zyrtare.



# Bundesliga rikthehet me ndeshjen Bayern - Hoffenheim



MUNCHEN, 23 GUSHT - Sonte (e premte) nis sezoni i ri në Bundesligën gjermane dhe pyetja e madhe është: a ekziston ndonjë ekip i aftë ta rrëzojë Bayernin nga froni? Lajmi i keq është se askush nuk beson realisht, mjafton të dëgjosh drejtorin sportiv të Stuttgartit, Michael Reschke: "Bayerni do të jetë kampion këtë sezon dhe gjithashtu në sezonet e ardhshme. Vetëm Bayerni vendos nëse do të kemi rivalitet në krye. Për të parë një garë të vërtetë për titull, duhet futur patjetër sistemi 'play-off'. Deri atëherë Bayern do ta dominojë dhe do t'ua marrë lojtarët më të mirë rivalëve". Në aspektin financiar "bavarezët" nuk kanë kundërshtar në Gjermani, çka i lejon të ketë mundësinë të blejë lojtarë cilësorë, t'i afrojë trajnerët më të mirë dhe të ketë një rrjet të shkëlqyer për zbulimin e talenteve. Në gjashtë titujt e fundit kampionë Bayerni ka grumbulluar mesatarisht 86 pikë për sezon, mesatare shumë e lartë krahasuar me gjashtë titujt e mëparshëm. Dortmundi, apo ndonjë klub tjetër, kanë mundur të kërcënojë apo rrëzojnë kampionët në fuqi nga froni, por në këtë moment për ta thyer Bayernin duhet një mesatare e frikshme pikësh, mbi 2.5 për ndeshje, gjë që në 55 vjet histori të Bundesligës e ka arritur vetëm Dortmundi i Jurgen Kloppit në vitin 2012, me 81 pikë, raporton "Telesport".
Që Bayerni ta humbasë titullin duhet që rendimenti i skuadrës së trajnerit Niko Kovaq të pësojë rënie të theksuar dhe të bëjë shumë gabime, apo të ketë probleme të brendshme si në kohën kur iku Ancelotti. Por, përveç kësaj, do të duhej që klubet e tjera në Bundesligë të përmirësohen ndjeshëm. Me përjashtim të Dortmundit në sezonin 2015/16, asnjë ekip nuk e ka kaluar shifrën e 67 pikëve në pesë vjetët e fundit. Dortmund, Schalke, Leverkusen, Leipzig apo Hoffenheim duket se më shumë mendojnë për vendin e dytë për shkak të problemeve që kanë dhe paaftësisë për të shpenzuar shifra të mëdha në tregun e transferimeve. Beteja pas Bayernit do të jetë mjaft interesante, sepse asnjë ekip nuk është dukshëm superior ndaj të tjerëve, ashtu si pritet e egër gara për mbijetesë, me Fortuna Dusseldorfin e Nurnbergun që janë kandidatë natyralë për rënie nga Bundesliga, duke qenë debutues, por edhe Hannoveri e Freiburgu pritet të vuajnë, duke parë buxhetin e vogël me të cilin punojnë.

**BUNDESLIGA**

**Të premten takohen:**
20:30 Bayern M. - Hoffenheim

**Të shtunën takohen:**
15:30Fortuna Duesseldorf - Augsburg
15:30 Freiburg - Eintracht Frankfurt
15:30 Hertha Berlin - Nuernberg
15:30Werder Bremen - Hannover 96
15:30 Wolfsburg - Schalke 04
18:30 B.Moenchengladbach - Bayer Leverkusen

**Të dielën takohen:**
15:30 Mainz 05 - VfB Stuttgart
18:00 Borussia Dortmund - Leipzig

## Grapci dhe Stanbacku përforcojnë Rahovecin

RAHOVEC, 23 GUSHT - KB Rahoveci ka realizuar të enjten dy transferime mjaft të qëlluara për edicionin e ri të basketbollit. Bëhet fjalë për ish-lojtarin e Pejës, Rron Grapcin dhe amerikanin James Stanback. Grapci ka nënshkruar kontratë njëvjeçare, kurse për disa vjet ka luajtur me plot sukses për skuadrën e Pejës, ndërsa për një kohë ishte edhe pjesë e skuadrave të tjera të Superligës. Transferimi tjetër i kësaj skuadre është James Steanback. Ky i fundit luan në pozitën 3/4. James ishte pjesë e disa kolegjeve në New Jersy.



## SHKURT

### Tare: Kemi skuadër për Ligën e Kampionëve

Lazio e nisi me humbje kampionatin e ri në Serinë A ndaj Napolit (1-2), por drejtori Sportiv i Lazios, Igli Tare, është optimist se kjo skuadër do të sigurojë një vend në Ligën e Kampionëve. "Kemi një organikë mjaft të mirë dhe mund ta synojmë Ligën e Kampionëve pa problem. Nuk është një Lazio për titull kampion, por një vend në katërshen e parë është më se i arritshëm. Kemi arritur t'i ruajmë lojtarët më të mirë të sezonit të kaluar si Immobile, Luis Alberto dhe Milinkoviç-Saviq, ndërsa kemi afruar edhe një sërë futbollistësh të tjerë që i shtojnë vlerat organikës. Jam i bindur se me punën e Inzaghit dhe të gjithëve bashkë, do të sigurojmë një vend në zonën e Ligës së Kampionëve", ka thënë Tare.

### Holanda organizon ceremoninë e lamtumirës për Sneijderin

Holanda ka publikuar listën paraprake me 34 futbollistët për miqësoren ndaj Perusë më 6 shtator dhe ndeshjen e Ligës së Kombeve ndaj Francës më 9 shtator. Mes tyre, në mënyrë të habitshme është edhe Wesley Sneijder, por nuk bëhet fjalë për një rikthim të tij te "Tulipanët". "Sneijder do të luajë ndaj Perusë ndeshjen e fundit me përfaqësuesen dhe federata i ka organizuar ceremoninë e lamtumirës", deklaroi trajneri i Holandës, Ronald Koeman. Aktualisht Wesley Snejder luan në Katar me skuadrën Al-Gharafa.

### Lëndohet Vitolo

Futbollisti i Atletico Madridit, Vitolo, do të mungojë dy muaj. 28-vjeçari u inkuadrua në lojën kundër Valencias në pjesën e dytë dhe pësoi një lëndim në gju. Në fakt, Vitolo në këtë edicion po e luan rolin e rezervistit për yllin francez të ardhur nga Monaco, Thomas Lemar.

### Kahn: Dominimi i Bayernit nuk i bën mirë Bundesligës

Oliver Kahn rikthehet të flasë për futbollin. Sigurisht tema kryesore e bisedës ishte Bayerni i tij, por dhe problemet që po has kampionati gjerman. Kahn u shpreh se ka besim tek trajneri i "bavarezëve", Niko Kovaq. "Sigurisht se ka njerëz të cilët mendojnë se ky do të jetë një sezon i keq për Bayernin. Unë nuk mendoj aspak kështu, por krejtësisht të kundërtën. Ata kanë disa lojtarë të acaruar në skuadër si Robert Lewandowski apo grupi që luan me Kombëtaren gjermane. Besoj se kjo do t'i motivojë më shumë. E kombinimi i kësaj gjëje me trajnerin Niko Kovaq, që kërkon disiplinë dhe rregull në ekip, do ta çojë Bayernin sërish në fitimin e Bundesligës". Por Kahn pranoi se dominimi i Bayernit u bënë shumë dëm ekipeve të tjera në Bundesligë. Fakti që kampionët e Gjermanisë e kanë fituar titullin për 6 herë rresht do të thotë se fitimi i këtij trofeu të jetë kushti minimal për një sezon të mirë. "Për një lojtar nuk është aq emocionuese të shkojë tek Bayerni, sepse fitimi i kampionatit shihet si një objektiv minimal. Natyrisht, në Bundesligë mund të fitosh shumë para, por nuk ka të njëjtën shikueshmëri si liga spanjolle apo ajo angleze. Edhe kampionati italian po e merr veten pak nga pak. Duhet që ekipet në Gjermani ta kuptojnë se dominimi i Bayernit nuk është gjëja më e mirë për ligën". Kahn konsiderohet legjendë e gjallë e Bayernit dhe Kombëtares gjermane. Në karrierën e tij ish-portieri i "bavarezëve" ka fituar tetë herë Bundesligën, një herë Ligën e Kampionëve dhe është shpallur kampion Evrope me Gjermaninë në vitin 1996.

### Rabioti, afër Barcelonës

Andre Rabiot është pranë largimit nga PSG-ja dhe dy ekipet që po insistojnë për ta afruar në ekip janëBarcelona dhe Juventus. "El Mundo" raporton se 23-vjeçari ka arritur akordin me klubin katalanas, i cili është gati t'i afrojë një rrogë prej 10 milionë eurosh në sezon. Ekipi aktual shpreson të rinovojë me mesfushorin, por francezët afrojnë më pak dhe mund të arrijnë deri në 7.2 milionë euro. PSG-ja nuk dëshiron të humbasë Rabiotin dhe do ta bëjë tentativën e fundit për ta bindur të qëndrojë, por duhet rritur oferta e tyre. Juventusi vazhdon ta monitorojë situatën, edhe pse në Spanjë janë të bindur se mesfushori i PSG-së, me të cilët i ka mbetur edhe një vit kontratë, do të jetë lojtari më i ri i Barcelonës.

Gjimnazi "Sami Frashëri"
Në bazë të nenit 11 (njëmbëdhjetë) të UA të MASHT-së nr.2/2016.
Këshilli Drejtues i shkollës Shkollës bënë këtë:

## FTESË PËR OFERTË

Ftojmë të gjitha agjencitë turistike të bëjnë ofertë për ekskursionin e maturantëve të Gjimnazit "Sami Frashëri" në Prishtinë. Ekskursioni do të zhvillohet në Republiken e Shqipërisë prej dates 22.09.2018. Kohëzgjatja e ekskursionit është 5 (pesë) pansione të plota.
Në ofertë paraqitet çmimi I akomodimit,ushqimit, transportit dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave nëpër vendet e veqanta turistike (siq janë: muzet keshtjellat etj) që parashihen në itinerarin e ekskursionit të përcaktuar nga Këshilli drejtue I shkollës.

**Agjencione turistike që konkurojnë duhet ti plotësojnë këto kushte:**

1. Agjencioni duhet të ketë lejen e punës dhe të jetë i licencuar me të drejtë qarkullimi jashtë shtetit. Ofertës ti bashkangjiten fotokopjet e këtyre dokumenteve.
2. Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e Agjencionit të akreditimeve të Ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve.
3. Të ketë dëshminë e kontrollit teknik të Autobusëve sipas procedurave ligjore.
4. Të ofrojë dëshmi për rezervimin e hapësirave hoteliere që i plotësojnë kërkesat e këshillit drejtues të shkollës sonë për ekskursion.
5. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e ekskursionit.
6. Për tërë personat e angazhuar në ekskursion nga agjencioni (shoferët) duhet të paraqesin certifikatat e mjekut.
7. Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e ekskursionit gjatë tërë kohëzgjatjes së tij.
8. OE i kërkohet të bëjë një konfirmim me shkrim që do të jetë në gjendje të mënjanojë defektet eventuale të ndonjë autobusi ose zëvendësimin e tij.
9. Afati I konkurimit është 7 ditë nga dita e publikimit në gazetë.
10. Dokumentet jashtë afatit të paraparë nuk pranohen.
11. Dokumentet jo complete nuk shqyrtohen.

-Dorzimi I ofertave bëhet në DKA në Prishtinë.
–Hapja e ofertave bëhet në DKA në Prishtinë.

Prishtinë më 22.08.2018

Nga Këshilli Drejtues I Shkollës
Gjimnazi "Sami Frashëri" në Prishtinë

---

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit - Opština Dragaš
Drejtorati për Arsim dhe Kultur
Direktorijat za Prosvetu i Kulturu
Nr. Br. 13/522
06-08 20 18
Dragash - Dragaš

SHML"RUZHDI BERISHA" DRAGASH
E;mail: profi-history@hotmail.com **tel.029281548** Tel. 044 112-900

Nr.pr. 990
Dragash me: 06.08.2018

Për: DKA

Drejtoria e SHML "Ruzhdi Berisha"në Dragash, në bazë të UA.02/2016 neni 11 pika 1 dhe 2 fton:

### FTESË PËR OFERTË

Ftojmë të gjitha kompanitë e autobusëve të interesuara të paraqesin ofertat e tyre për ekskursion të nxënësve maturant.

**KUSHTET E OFERTIMIT;**

1. Agjencioni i licencuar
2. Kontrolla teknike e kryer në bazë te procedurave ligjore
3. Të kete numer te caktuar te autobusëve për nevoja të shkollës
4. Autobuset komfor dhe me klimatizim
5. Agjencioni të mos ketë referenca negative
6. Drejtuesit e autobusëve të posedojnë dokumentacionin e nevojshëm
7. Agjencioni është i obliguar të siguroj përkujdesje shendetësore për nxënës dhe personel të shkollës
8. Agjencioni duhet të siguroj vendosjen dhe ushqimim për nxënës dhe personel
9. Të kalkulohet çmimi për kokë të nxënësit

Shkolla i ka 8(Tetë ) paralele ku perafërsisht janë 180 nxënës. Numri i saktë i nxënësve të cilet shkojnë në ekskursion do të dihet ditën e hapjes së ofertave .
Ekskursioni do të organizohet jashtë Republikës së Kosovës konkretisht në Republiken e Shqipërisë, qellimi është vizita e disa prej qyteteve të Shqipërisë si dhe vizita e disa monumenteve historike në Shqipëri. Ekskursioni është 5 ditor.
Ofertat dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit në emer të shkollës që ka bëre ftesen për ofertë.
Afati i dorëzimit të ofertave bëhet prej datës 09.08.2018 deri me 17.08.2018 në ore 13.30 kur do të bëhet edhe hapja e ofertave ne DKA në Dragash.

Drejtori:
Shukri Nebija

---

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

---

**NJOFTIMI PËR PËR FINACIM PUBLIK TË ORGANIZATAVE JOQEVERITARE**
*Sipas Rregullores MF Nr.04/2017 për financimin publik te OJQ-ve*

I AUTORITETI KONTRAKTUES: Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Adresa: Rr. Nene Terezë nr.36 Prishtinë
II LËNDA E PUBLIKIMIT: Financim publik i OJQ-ve.
II.1.1 Titulli i subvencionit nga autoriteti kontraktues: FINACIM PUBLIK I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE
II.1.2 Lokacioni i dorëzimit: Rr. Nene Tereza nr. 36 Prishtinë
III INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE sipas Rregullores MF Nr.04/2017 për financimin publik te OJQ-ve
